

Grup autorësh

LIBËR PËR MËSUESIN
Teknologjia
e Informacionit
dhe e Komunikimit 11

BOTIME



Përmbajtje

Hyrje	5
Planifikimi i kurrikulës për klasën XI-të	11
PLANI VJETOR KLASA XI	12
PLANIFIKIMI 3-MUJOR (SHTATOR – DHJETOR)	17
PLANIFIKIMI 3- MUJOR (JANAR – PRILL)	22
PLANIFIKIMI 3-MUJOR (PRILL – QERSHOR)	26
Planifikimi ditor (modele ditarësh)	30
Test tremujori i parë	48
Test tremujori i dytë	68
Test tremujori i tretë	77
Vlerësimi i punës së bërë gjatë këtij projekti	80
Vlerësimi i aftësisë së nxënësit në përdorimin e informacionit	84
Vlerësimi oi portofolit të lëndës së TIK-ut	88

Hyrje

I dashur koleg!

Në kohët e sotme, teknologjia dhe TIK-u janë kthyer në një mënyrë jetese ndaj së cilës nxënësit shfaqin interes. Arsimi teknologjik është një komponent thelbësor i kurrikulës, ku nxënësit zhvillojnë aftësitë digjitale për të përdorur TIK-un në mënyrë efektive dhe të përshtatshme për të pasur akses, për të krijuar dhe komunikuar informacion dhe ide, për të zgjidhur probleme dhe për të punuar së bashku në të gjitha fushat e edukimit në shkollë dhe në jetën përtej shkollës. Aftësia e TIK-ut i përfshin nxënësit në procesin e të mësuarit për teknologjinë digjitale, duke e bërë të vlefshme për ta, për t'iu përshtatur si teknologjive që evoluojnë ashtu dhe t'u japë njohuri mbi kufizimin e rreziqeve për veten në një mjedis digjital. Në një mjedis digjital, ku ka ndryshime të shpejta dhe të vazhdueshme në mënyrën se si njerëzit ndajnë, përdorin, zhvillojnë dhe komunikojnë me TIK-un, të rinjtë duhet të jenë shumë të aftë në përdorimin e tij. Për të marrë pjesë në një ekonomi të bazuar në dije dhe për të qenë të fuqishëm në një shoqëri teknologjike të sofistikuar për të sotmen dhe në të ardhmen, nxënësve u nevojiten njohuri, aftësi dhe besim në TIK për të realizuar detyrat në shkollë, shtëpi, punë dhe në komunitetet e tyre. Si qytetarë, ata duhet të jenë të aftë të bëjnë gjykime vetjake mbi çështjet që lidhen me ndikimin e teknologjisë në jetët e tyre, në shoqëri dhe në mjedis.

Nxënësit e moshës digjitale vijnë në shkollë me njohuri, gjykime, opinione dhe pyetje të marra nga burime të pafundme digjitale të informacionit të cilat mësuesi duhet t'i konsiderojë si pjesë të kurrikulës në tërësinë e saj. "TIK-u dhe Teknologjia" janë një formë e veçantë e veprimtarisë krijuese, ku njerëzit ndërveprojnë me mjediset e tyre duke përdorur materialet, inputet dhe proceset e duhura në përgjigje të nevojave, dëshirave dhe mundësive të tyre. Ato integrojnë shprehitë për zgjidhjen e problemeve dhe shprehitë praktike në prodhimin e produkteve dhe të sistemeve të dobishme të pranishme në shumë fusha të të nxënësve, por veçanërisht në fushën e shkencave natyrore.

Teknologjitë e informacionit dhe të komunikimit janë të shpejta dhe të automatizuara, interaktive dhe multimodale, mbështesin komunikimin e shpejtë dhe përfaqësimin e dijes në shumë audienca dhe përshtatjen e saj në kontekste të ndryshme. Ato transformojnë mënyrat e të menduarit dhe të mësuarit të nxënësve, duke i bërë ata më të aftë dhe të përgjegjshëm se si, ku dhe kur ata mësojnë.

Korniza konceptuale e programit

Hartimi i programit lëndor rrjedh nga: korniza kurrikulare e arsimit të mesëm të lartë, plani mësimor për kurrikulën bërthamë në arsimin e mesëm të lartë si dhe standardet e fushës kurrikulare ku bën pjesë kjo lëndë. Për të siguruar përdorimin sa më të mirë të programit është e vlefshme njohja me dokumentet e lartpërmenduarat. Te korniza kurrikulare vëmendje e veçantë u duhet kushtuar:

- synimeve të përgjithshme të kurrikulës së arsimit parauniversitar;
- synimeve të temave ndërkurrikulare;
- vlerësimit të nxënësve me notë;
- parimeve të mësimdhënies/mësimnxënies.

Në mënyrë që tërësia e dokumenteve zyrtare (korniza kurrikulare, standardet e fushës së të nxënësve dhe programi lëndor) të zbatohet më së miri në dobi të nxënësve, përdoruesit e kësaj tërësie duhet të njohin thellë programet lëndore të lëndës së TIK-ut për klasat paraardhëse dhe klasat pasardhëse. Gjithashtu, përdoruesve të këtij programi u lind nevoja të njohin standardet e të gjitha fushave të tjera të të nxënësve dhe të gjitha programet e lëndëve të të njëjtit vit. Zbatimi i këtij programi kërkon që kurrikula e TIK-ut të vendosë theksin në rrugën dhe procedurat e veprimit shkencor me objektet mësimore, që metodat verbale të përdorura gjerësisht sot, të zëvendësohen me përdorimin e metodave shkencore.

Ajo duhet t'i nxisë nxënësit të jenë aktivë dhe të marrin përgjegjësi për të mësuarit e tyre; të përdorë strategji dhe teknika mësimore që nxisin ndërveprimin, pjesëmarrjen mësimore dhe mbështesin kërkimin me TIK të nxënësve. Zbatimi i programit duhet të bëhet duke respektuar parimet e barazisë gjinore, etnike, kulturore, racore, fetare.

Si i tillë programi i TIK-ut i shërben:

Nxënësit për zhvillimin e kompetencave kyçe dhe kompetencave të fushës së teknologjisë dhe TIK-ut, në mënyrë që ata të përballojnë sfidat e jetës dhe të integrohen në shoqëri.

Mësuesit për planifikimin, realizimin dhe vlerësimin e veprimtarisë mësimore dhe arritjet e nxënësve në klasë dhe jashtë saj.

Prindit për njohjen e rezultateve të pritshme të fëmijëve dhe kriteret e vlerësimit në periudha të caktuara kohore.


Hartuesit të teksteve mësimore dhe të materialeve ndihmëse për mësuesit dhe nxënësit.

Programi i TIK-ut ka në thelb të tij krijimin e kushteve për ndërtimin e **kompetencave të fushës/lëndës** si dhe të kompetencave kyçe që lidhen me to. Realizimi i temave ndërkurrikulare nëpërmjet fushës së teknologjisë dhe TIK-ut është një komponent i rëndësishëm i programit për kontributin e tij në shoqëri dhe në jetën e përditshme. Në program, gjithashtu, përshkruhet lidhja e TIK-ut me fushat e tjera, në mënyrë që kurrikula e arsimit bazë të shihet si një e tërë për realizimin e qëllimit kryesor të formimit të nxënësve.

Programi përmban 5 tematika, të cilat krijojnë kushte që nxënësi të ndërtojë dhe zbatojë njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat, në funksion të kompetencave të lëndës dhe kompetencave kyçe. Në program paraqitet edhe **koha mësimore për secilën tematikë**, që ndryshon nga klasa në klasë.

Përdorimi i metodologjive efikase në mësimdhënie është kusht për zbatimin e programit, për arritjen e kompetencave nga ana e nxënësve, duke i dhënë secilit mundësinë të shfaqë dhe të zhvillojë potencialin që zotëron brenda vetes. Në këtë program, **vlerësimi i nxënësve** është komponent thelbësor për përmirësimin e arritjeve të nxënësve dhe procesit të të nxënësve.

Programi i TIK-ut, nga pikëpamja e organizimit të përmbajtjes, paraqitet në diagramin e mëposhtëm.



Qëllimi i programit të lëndës TIK

Qëllimi i lëndës TIK

Natyrë dhe fusha e aftësive të TIK-ut nuk është fikse, por është në funksion të zhvillimeve më të reja teknologjike. Kjo është e qartë me shfaqjen e teknologjisë së përparuar të internetit gjatë viteve të fundit dhe ndryshimet që rezultojnë në mënyrat që nxënësit të ndërtojnë njohuritë dhe ndërveprojnë me të tjerët.

Nxënësit zhvillojnë aftësi në përdorimin e TIK-ut për punët që lidhen me aksesin e informacionit dhe menaxhimin, krijimin e informacionit dhe prezantimin, zgjidhjen e problemeve, marrjen e vendimeve, komunikimin, të shprehurit krijues dhe arsyetimin empirik. Kjo përfshin kryerjen e hulumtimit duke krijuar produkte multimediale të informacionit, analizimin e të dhënave, hartimin e zgjidhjes së problemeve, kontrollin e proceseve dhe të pajisjeve duke punuar në mënyrë të pavarur dhe në bashkëpunim me të tjerët.

Nxënësit zhvillojnë njohuritë, shkathtësitë dhe dispozitat rreth TIK-ut dhe përdorimit të tij dhe aftësinë për t'i transferuar të gjitha këto mjedise dhe aplikime. Ata mësojnë të përdorin TIK-un me kujdes, duke kuptuar mundësitë e tij, kufizimet dhe ndikimin tek individët, grupet dhe komunitetet.

Qëllimi i programit të fushës së TIK-ut:

Programi i TIK-ut ka për qëllim të zhvillojë njohuritë, të kuptuarit dhe aftësitë për të siguruar nxënësit që, individualisht dhe në bashkëpunim:

- të hetojnë, projektojnë, planifikojnë, menaxhojnë, krijojnë dhe vlerësojnë zgjidhjet;
- të jenë krijues, inovativë dhe me iniciativë kur përdorin tradicionalen, bashkëkohoren dhe teknologjitë e reja dhe të kuptojnë se si janë zhvilluar teknologjitë me kalimin e kohës;
- të marrin vendime të informuara dhe etike në lidhje me rolin, ndikimin dhe përdorimin

- e teknologjive në ekonomi, mjedis dhe shoqëri për një të ardhme të qëndrueshme;
- të angazhohen me besim dhe përgjegjësi që të zgjidhin dhe të manipulojnë me teknologjitë e përshtatshme - materialet, të dhënat, sistemet, komponentët, mjetet dhe pajisjet, kur projektojnë dhe krijojnë zgjidhje;
- të kritikojnë, analizojnë dhe vlerësojnë problemet, nevojat apo mundësitë për të identifikuar dhe për të krijuar zgjidhje.

Kompetencat e fushës

Vazhdimësia e aftësisë TIK të të mësuarit është e organizuar në pesë kompetenca të fushës të ndërlidhura:

- Zbatimi i protokolleve dhe praktikave sociale dhe etike kur përdorin TIK-un.
- Hetimi me TIK.
- Krijimi me TIK.
- Komunikimi me TIK.
- Menaxhimi dhe veprimi me TIK.

Lidhja e kompetencave kyçe me kompetencat e fushës

Ndërtimi dhe zbatimi i kompetencave kyçe nga nxënësit gjatë procesit të mësimdhënies dhe nxënies, kërkon që mësuesi të mbajë parasysh lidhjen e kompetencave kyçe me kompetencat e fushës për secilën shkallë. Për të realizuar në praktikë këtë lidhje, mësuesi duhet të përzgjedhë situatat, veprimtaritë, metodat, dhe mjetet e përshtatshme të procesit të të nxënit. ***Kompetenca përcaktohet si integrim i njohurive, shkathtësive dhe qëndrimeve që një nxënës duhet t'i fitojë gjatë procesit të nxënies.***

Kompetenca demonstron nga nxënësi (njohuri), bazohet në performancën e tij (aftësi), si dhe bazohet në perspektivën e sjelljes (qëndrim). Organizimi i mësimit të TIK-ut me bazë kompetencat përqendrohet në atë që nxënësi duhet të dijë, të bëjë saktë dhe të shpjegojë pse e bën. Kur nxënësi realizon kompetencën digjitale, ai njëkohësisht është duke zhvilluar edhe kompetencat kyçe. P.sh. Kompetenca digjitale “Zgjidhja problemore” përfshin shumë nga strategjitë e zgjidhjes së situatave të ndryshme problemore në shoqëri dhe në jetën e përditshme duke përdorur teknologjinë.


Për të realizuar lidhjen e kompetencave kyçe me kompetencat e fushës së TIK-ut mësuesi ndjek këta hapa:

- përzgjedh rezultatin/et e të nxënit për kompetencat kyçe që synon të arrijë nxënësi në shkallën përkatëse;
- zbërthen në rezultate të nxëni për kompetenca kyçe për secilin vit mësimor rezultatin/et e të nxënit për shkallë, për kompetencat kyçe;
- përzgjedh rezultatin/et e të nxënit për shkallë për kompetencat e fushës/ lëndës së TIK-ut që synon të arrijë nxënësi;
- zbërthen në rezultate të nxëni për kompetencat e fushës/lëndës së TIK-ut për vit mësimor, rezultatin/et e të nxënit për shkallë;
- përzgjedh përmbajtjen/et mësimore, mjetet digjitale, metodologjinë e mësimdhënies, përmes të cilave realizon rezultatet e të nxënit të kompetencave digjitale në një vit mësimor, si dhe rezultatet e të nxënit për kompetencat kyçe në një vit mësimor;
- planifikon mësimdhënien duke përfshirë periudhën kohore gjatë së cilës do t'i arrijë rezultatet e të nxënit brenda vitit shkollor;
- kryen analiza dhe vlerësime të ecurisë së nxënësve pas realizimit të orëve mësimore,

detyrave, projekteve, për të verifikuar arritjet e rezultateve të nxënësve për vit mësimor dhe shkallë për fushën e Teknologjisë dhe TIK-ut.

Kompetencat që formohen përmes tematikave

Bazuar në këtë kurrikul, lënda e TIK-ut synon të përmbushë 5 kompetencat e fushës, të cilat lidhen me kompetencat kyçe që një nxënës duhet të zotërojë gjatë jetës së tij dhe që arrihen nëpërmjet 5 tematikave kryesore.



Përmbajtja e shkallës së pestë

Në programin e lëndës së TIK-ut për shkallën e pestë janë paraqitur përmbajtjet e tematikave:

- Bota e kompjuterit; (hardware dhe Software).
- Përpunimi digjital i të dhënave.
- Programimi në Web.
- JAVA .
- Programimi dhe algoritmika.

Këto tematika janë bazë për të ndërtuar njohuri, qëndrime e vlera. Tematikat janë baza për të siguruar rezultatet e të nxënësve, për çdo shkallë të paraqitura në tabelë në fillim të çdo tematike. Për secilën tematikë, sipas klasave të shkallës, janë paraqitur njohuritë për secilën klasë të

shkallës së pestë (klasa e dhjetë, klasa e njëmbëdhjetë). Aftësitë, qëndrimet dhe vlerat që duhet të demonstrojë nxënësi lidhur me tematikat përkatëse paraqiten në nivel shkalle për secilën shkallë. Koha për secilën tematikë lidhet së pari me rëndësinë e tematikës dhe së dyti me shkallën e vështirësisë së saj për t'u përvetësuar nga nxënësit. Sasia e orëve mësimore për secilën tematikë është rekomanduese. Mësuesit janë të lirë të ndryshojnë me 10% (më

shumë ose më pak) orët e rekomanduara për secilën tematikë. Përdoruesit e programit duhet të respektojnë sasinë e orëve vjetore të lëndës, si edhe ndarjen e orëve sipas tematikave. Në programin e arsimit të mesëm të lartë mësuesit duhet të kenë në konsideratë që kjo lëndë duhet të bazohet në realizimin e aftësive që i duhen nxënësit për gjatë gjithë jetës. Që nxënësit të aftësohen në këtë lëndë ata duhet të kenë në dispozicion orë që u mundësojnë praktikimin e njohurive të reja dhe infrastrukturën e përshtatshme në shkollë.

Mësuesit dhe hartuesit e teksteve janë të lirë t'i organizojnë kapitujt dhe renditjen e tyre, por ajo që është e rëndësishme dhe duhet marrë në konsideratë është se tematikat zgjasin përgjatë gjithë vitit shkollor, kështu që kapitujt e teksteve nuk mund të jenë të ndarë , por duhet të kenë ndërlidhje dhe vazhdimësi. Gjithashtu mësuesit duhet të marrin në konsideratë që situatat janë në qendër të zhvillimit të orës mësimore dhe nëpërmjet situatave të synohet arritja e njohurive, aftësive dhe qëndrimeve. Ndaj do të ishte dhe në ndihmë të mësuesit nëse tekstet do të ishin të pasura me situata praktike të marra nga jeta e përditshme.

SHKOLLA: _____

Planifikimi i kurrikulës për klasën XI-të

Fusha: Teknologji e informacionit dhe e komunikimit

LËNDA: TIK

MËSUESI: _____

Planifikimi përmban: Planin vjetor; Planet 3-mujore;
Formati i Planifikimit të orës së mësimit

Viti shkollor _____

PLANI VJETOR KLASA XI

LËNDA: TIK 11 (Bërthamë)

Punët praktike, përsëritjet dhe testet përmbledhës realizohen në fund të tre-mujorëve 1,2 dhe 3.

SHPËRNDARJA E PËRMBAJTJES SË LËNDËS		
TEMATIKAT	SHTATOR – DHJETOR ORËT = 12 orë <i>Teori = 9 orë, Projekt = 1 orë, Vlerësim i portofolit = 1 orë, Test për tre-mujorin I = 1 orë</i>	JANAR – MARS ORËT = 12 orë <i>Teori = 9 orë, Vlerësim i portofolit = 1 orë, Projekt = 1 orë, Test për tre-mujorin II = 1 orë</i>
BOTAE KOMPJUTERIT 3 orë	<p>1.1 Siguria e rrjetit dhe rëndësia e saj. Kriptografia</p> <p>1.2 Njohja e sulmeve ndaj rrjetit</p> <p>1.3 Çfarë mund të bëjmë për të qenë më të sigurt në internet?</p>	PRILL – QERSHOR ORËT = 12 orë <i>Teori = 9 orë, Projekt = 1 orë, Vlerësim i portofolit = 1 orë, Test për tre-mujorin III = 1 orë</i>
PËRPUNIMI DIGJITAL I TË DHËNAVE (ACCESS) 9 orë	<p>2.1 Njohuri mbi bazat e të dhënave</p> <p>2.2 Njohja me programin ACCESS</p> <p>2.3 Llojet e të dhënave dhe çelësi primar</p> <p>2.4 Krijimi i tabelave në MS Access 2013</p> <p>2.5 Modifikimi i tabelave</p> <p>2.6 Kërkesat dhe formularët në Ms Access</p> <p>2.7 Projekt (ora e parë)</p> <p>“Integrimi i bazave të të dhënave nga një aplikacion në Visual Basic”</p> <p>2.8 Vlerësimi i portofolit personal</p> <p>2.9 Test për tre mujorin (linjat I, II, tre-mujori i parë)</p>	

<p>PROGRAMIMI NË WEB 6 orë</p>		<p>3.1 Strukturat e kontrollit në <i>JavaScript</i> 3.2 Funkcionet kryesore në <i>JavaScript</i> 3.3 Vlefshmëria e të dhënave në formular 3.4 Gjuha e programimit <i>PHP</i> 3.5 Metoda <i>GET</i> e programimit <i>PHP</i> 3.6 Metoda <i>POST</i> e programimit <i>PHP</i></p>	
<p>PROGRAMIMI DHE ALGORITMIKA (VISUAL BASIC) 6 orë</p>		<p>4.1 Përbërësit e programit <i>Visual Basic</i> 4.2 Ndryshoret dhe operatorët aritmetikë në <i>VB</i> 4.3 Zbatimi i cikleve në <i>VB</i> 4.4 Krijimi dhe zbatimi i një programi të thjeshtë 4.5 Projekt (ora e dytë) “Integrimi i bazave të të dhënave nga një aplikacion në <i>Visual Basic</i>” 4.6 Test për tre-mujorin (linjat I, II, tre-mujori II)</p>	

<p>PROGRAMIMI DHE ALGORITMIKA (VISUAL BASIC) 4 orë</p>			<p>4.7 Funkcionet në VB 4.8 Ndërtimi i funksioneve 4.9 Integrimi i bazave të të dhënave në VB 4.9 Përdorimi i bazave të të dhënave nga një aplikacion në VB</p>
<p>GJUHA E PROGRAMIMIT JAVA 8 orë</p>			<p>5.1 Krijimi i klasave në Java 5.2 Vetitë e klasave në Java 5.3 Zgjidhja e problemeve nëpërmjet programeve në Java 5.4 Klasat në Java. 5.5 Objektet në Java. Konstruktoret dhe destruktoret. 5.6. Projekt (ora tretë) “Integrimi i bazave të të dhënave nga një aplikacion në Visual Basic” 5.7 Vlerësimi i portofolit personal 5.8 Test për tre-mujorin (linjat I, II, tre-mujori III).</p>

PLANI MËSIMOR VJETOR KLASA XI

FUSHA: TIK

LËNDA: Teknologjia e informacionit dhe e komunikimit XI

Tematikat	Shpërndarja e përmbajtjes lëndore për realizimin e kompetencave		
	Shtator – Dhjetor 12 orë	Janar – Mars 12 orë	Prill – Qershor 12 orë
BOTAE KOMPJUTERIT	Rrjeti <i>(Siguria e rrjetit, rëndësia e saj, kriptografia, njohja e sulmeve ndaj rrjetit, ç'mund të bëjmë për të qenë më të sigurt në internet)</i> (3 orë)		
PËRPUNIMI DIGJITAL I TË DHËNAVE (ACCESS)	Përpunimi digjital i të dhënave <i>(njohuri mbi bazat e të dhënave, njohja me programin ACCESS, llojet e të dhënave dhe çelësi primar, krijimi, modifikimi i tabelave, kërkesat dhe formularët)</i> (9 orë)		
PROGRAMIMI NË WEB GJUHA E PROGRAMIMIT JAVA		Programin në Web, JAVA <i>(Strukturat e kontrollit në Javascript, funksionet kryesore në Javascript, vlefshmëria e të dhënave në formular, gjuha e programimit PHP)</i> (6 orë)	Gjuha e programimit Java <i>(Krijimi i klasave në Java, vetitë e klasave, zgjidhja e problemeve nëpërmjet programeve në Java, klasat në objektet në Java, konstruktorët dhe destrukturët)</i> (8 orë)

<p>PROGRAMIMI DHE ALGORITMIKA (VISUAL BASIC)</p>		<p>Programim, Visual Basic (Përbërësit e programit Visual Basic, ndryshoret dhe operatorët aritmetikë në VB, zbatimi i cikleve në VB, krijimi dhe zbatimi i një programi të thjeshtë) (6 orë)</p>	<p>Programim, Visual Basic (Funksionet në VB, ndërtimi i funksioneve integrimi i bazave të të dhënave në VB, përdorimi i bazave të të dhënave nga një aplikacion në VB) (4 orë)</p>
---	--	---	---

PLANIFIKIMI 3-MUJOR (SHTATOR – DHJETOR)
FUSHA: TIK
LËNDA: TIK

<p>Tematika: Bota e kompjuterit (<i>hardware, software</i>)</p>	<p>Përshkrimi i tematikës: <i>Nxënësit zhvillojnë aftësitë e tyre, kreativitetin dhe njohuritë në shkencë kompjuterike, mediat digjitale dhe të teknologjisë së informacionit.</i> <i>Identifikimi dhe zgjidhja e problemeve ndërmjet komponentëve kompjuterike dhe bashkëveprimi ndërmjet tyre.</i> <i>Në këtë tematikë, nxënësit/et njihen me nocionin e sigurisë së rrjetit dhe rëndësinë e saj, kërcënimet që vijnë nga interneti, si dhe mënyrat e shmangies së tyre. Gjithashtu, nxënësit/et njihen me termin kriptografi si dhe teknikat e mbrojtjes së rrjetit.</i> <i>Më tej, ata/ato njihen me komponentët e sigurisë së komunikimit si dhe sigurisë web, gjithashtu do të mësojnë disa mënyra se si të jenë më të sigurt në rrjet.</i></p>
<p>Rezultatet e të nxënit për kompetencat e fushës <i>Zbatimi i protokolleve dhe praktikave sociale dhe etike kur përdorin TIK</i> <i>Nxënësi:</i></p>	<ul style="list-style-type: none"> - <i>identifikon ndikimin e TIK-ut në shoqëri: vlerëson ndikimin e TIK-ut në vendin e punës dhe në shoqëri dhe diskuton për rolin e tij në të ardhmen dhe se si ata mund të ndikojnë në përdorimin e tij.</i> - <i>Menaxhimi dhe Operimi TIK:</i> Nxënësi: - <i>zgjedh dhe përdor hardware dhe software: argumenton zgjedhjen dhe optimizon funksionimin e një sërë pajisjesh të zgjedhura dhe funksioneve software për të përfunduar detyra të veçanta, për qëllime të ndryshme dhe në kontekste të ndryshme shoqërore;</i> - <i>kupton sistemet TIK: zbaton të kuptuarit e komponentëve TIK të sistemit të rrjetit për të bërë ndryshime në funksionet, proceset, procedurat dhe pajisjet për të përshtatur qëllimin e zgjidhjes;</i> - <i>menaxhon të dhënat digjitale: menaxhon dhe ruan të dhëna të sigurta në disa medime magazinimi dhe formate.</i>

<p>Tematika: Përpunimi digjital i të dhënave</p> <p>Përshkrimi i tematikës: <i>Nxënësit marrin njohuri dhe aftësi që kanë të bëjnë me: funksionet kryesore të një programi aplikativ të paketës MS Office, Access-it. Në këtë tematikë, nxënësit/et njihen me nocionin baza të dhënash, termat kryesorë të tyre si dhe objektet e bazave të të dhënave. Gjithashtu, ata/ato njihen me programin Ms Access 2013, krijimin e një baze të dhënash, si dhe komponentët kryesorë të dritares së bazës së të dhënave, tipat e të dhënave dhe nocionin e çelësit primar. Ata/ato mësojnë të krijojnë dhe të modifikojnë tabelat në Access, të ruajnë një bazë të dhënash, si dhe të krijojnë kërkesa dhe formularë.</i></p>	<p>Rezultatet e të nxënit për kompetencat e fushës:</p> <p><i>Krijimi me TIK:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>gjeneron ide, plane dhe procese:</i> zgjedh dhe përdor TIK-un për të artikuluar idetë dhe konceptet dhe planifikon zhvillimin e zgjidhjeve komplekse; - <i>gjeneron zgjidhje për sfidat dhe detyrat në fushën e mësimit:</i> harton, modifikon dhe menaxhon zgjidhje komplekse digjitale ose rezultate krijuese multimodale ose transformime të dhënash për një gamë audiencash dhe qëllimesh; - <i>menaxhon të dhënat digjitale:</i> menaxhon dhe ruan të dhëna të sigurta në disa medime magazinimi dhe formate.
---	--

Nr	Kapitulli	Temat mësimore	Situata e parashikuar e të nxënit	Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve	Vlerësimi	Burimet
1.	Bota e kompjuterit (3 orë)	Siguria e rrjetit dhe rëndësia e saj. Kriptografia	Çfarë masash paraprake duhet të ndërmerren nga një individ, shoqëri, biznes, institucion qeveritar, që të dhënat të mos përdoren nga persona të pa autorizuar, rrjeti që ata përdorin të jetë i sigurt, llogaritë e tyre elektronike?	Metoda interaktive, bashkëvepruese, diskutime, gjithëpërfshirëse; Puna në grup dhe puna individuale; Hetimi dhe zbulimi; Zbatime praktike brenda dhe jashtë klase;	Vlerësim diagnostikues, intervistë me një listë treguesish; vetëvlerësim me listë kontrolli. Vlerësim për të nxënë (Vlerësim formues) vlerësimi i përgjigjeve me gojë; vlerësimi i punës në grup; vlerësim mes nxënësish; vlerësim i aktivitetit gjatë debatoreve në klasë; vlerësim i detyrave të shtëpisë; vetëvlerësim; intervistë me një listë treguesish; vëzhgim me një listë të plotë treguesish, portofol, prezantim me gojë ose me shkrim, projekt kurrikular.	Teksti TIK për klasën XI, pajisje fundore, media; Teksti i mësuësit për klasën e XI; Materiale nga interneti; Materiale nga enciklopedi;
2.		Njohja e sulmeve ndaj rrjetit				
3.		Çfarë mund të bëjmë për të qenë më të sigurt në internet?				
4.	Njohuri mbi bazat e të dhënave	Njohuri mbi bazat e të dhënave	Mblidhni informacion nga interneti rreth bazave të të dhënave dhe konceptet e tyre dhe gjeni: 1. karakteristikat kryesore të tyre; 2. historikun e zhvillimit të bazave të të dhënave; 3. përdorimet e tyre në jetën e përditshme.	Metoda integruese; Bashkëbisedim; Teknika që zhvillojnë mendimin kritik dhe krijues; Prezantime në forma të ndryshme TIK; Projekte kurrikulare; Konkurse.	Tëks nga fusha të tjera; Slide/ materiale të krijuara nga mësuësi;	
5.						Njohja me programin ACCESS
6.	Përpunimi digital i të dhënave (9 orë)	Njohja me programin ACCESS	Tashmë ju njihni disa nga programet e paketës Microsoft Office. Listoni disa prej tyre. Ç'mund të thoni për programin Ms Access 2013? Përse shërben ai? Diskutoni me shokët.	Metoda integruese; Bashkëbisedim; Teknika që zhvillojnë mendimin kritik dhe krijues; Prezantime në forma të ndryshme TIK; Projekte kurrikulare; Konkurse.	Tëks nga fusha të tjera; Slide/ materiale të krijuara nga mësuësi;	
6.						Njohja me programin ACCESS

10.	Projekt (ora e parë). “Integrimi i bazave të të dhënave nga një aplikacion në <i>Visual Basic</i> ”	<i>Detyrë krijuese, krijojnë produkte digjitale.</i>			
11.	Vlerësimi i portofolit personal				
12.	Test për tre-mujorin (linjat I, II, tre-mujori i I)				

PLANIFIKIMI 3- MUJOR (JANAR – PRILL)
FUSHA: TIK
LËNDA: TIK

Tematika: Programimi në Web

Përshkrimi i tematikës:

Kjo tematikë përqendrohet në ndërtimin e aplikacioneve web. Për të krijuar ndërveprim midis përdoruesit dhe aplikacionit, përdoret kryesisht gjuha *JavaScript*. Ne do të shohim se si krijohen ngjarjet në faqet web, si trajtohen ato nga funksionet në *JS* dhe se cilat janë funksionet kryesore të *JS*, që përdoren në ndërtimin e formularëve. Më tej do të shohim se si aplikacionet mund të ekzekutohen në anën e serverit, duke u përqendruar në gjuhën *PHP*. Në të janë ndërtuar disa platforma të njohura, si *Facebook*, *Wikipedia*, *Flickr* etj.

Rezultatet e të nxënit për kompetencat e fushës:

Nxënësit:

- *menaxhojnë dhe organizojnë* të dhëna duke përdorur mjete gjuhen e programimit;
- *mbajnë një koleksion të gjerë të produkteve* digjitale që përputhen me konventat e prezantimit të TIK-ut dhe i transformojnë ato sipas programeve të kërkuara.

Tematika: Programimi dhe Algoritmtika (aplikimi i formulave bazë)

Përshkrimi i tematikës

Në këtë tematikë do të përqendrohemi te zhvillimi i aplikacioneve në *Visual Basic*. Do të shohim se si krijohen projektet në *VB*, se si ndërtohen programe të thjeshta në të, duke përdorur variablat dhe operatorët aritmetikë, logjikë, krahasues dhe bulean të kësaj gjuhe. Disa funksione të gatshme në *VB*, si *MsgBox* dhe *InputDialog*, do t'i trajtojmë me anë të shembujve dhe do të shpjegojmë se si mund të krijoni ju vetë funksionet tuaja. Në fund, do të tregojmë se si mund të përpunohen të dhënat e ruajtura në bazat e të dhënave, në saje të krijuara në *VB*.

Rezultatet e të nxënit për kompetencat e fushës:

- ***kreativiteti dhe inovacioni duke përdorur teknologjinë:*** përdor kompjuterin për të zhvilluar të menduarit krijues dhe konstruktiv apo për të nxitur inovacionin dhe kreativitetin;
- ***kërkimi dhe gjetja e informacionit:*** përcakton strategjinë e kërkimit të informacionit duke përdorur kompjuterin; gjen, organizon, analizon, vlerëson, përpunon dhe përdor informacionin nga një shumëllojshmëri e burimeve dhe mediave; përzgjedh burimet e informacionit apo mjetet digjitale bazuar në përshatshmërinë e tyre për kryerjen dhe zgjidhjen e një sërë detyrash;
- ***mendimi kritik, zgjidhja e problemit dhe vendimmarrja:*** vlerëson sistemet e informacionit dhe zgjidhjet e tyre në termat e mbledhjes së kërkesave, të reja dhe qëndrueshmërisë;
- ***operacionet bazë dhe konceptet teknologjike:*** shpjegon se si sistemet e informacionit dhe zgjidhjet e tyre përmbushin nevojat duke marrë parasysh qëndrueshmërinë.

Nr	Kapitulli	Temat mësimore	Situata e parashikuar e të nxënësve	Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve	Vlerësimi	Burimet
1.		Strukturat e kontrollit në <i>JavaScript</i>	Përdor gjuhën <i>JavaScript</i> për të krijuar ndërveprim midis përdoruesit dhe aplikacionit.	Metoda interaktive, bashkëvepruese, diskutime gjithëpërfshirëse; Puna në grup dhe puna individuale;	Vlerësim diagnostikues, intervistë me një listë treguesish; vetëvlerësim me listë kontrolli.	Teksti i TIK për klasën XI, pajisje fundore, media; Teksti i mësuesit për klasën e XI;
2.		Funksionet kryesore në <i>JavaScript</i>	Vendos ngjarjen e duhur në elementët HTML sipas sintaksës së duhur dhe realizon një ngjarje në HTML duke përdorur vetitë e JS.	Hetimi dhe zbulimi; Zbatime praktike brenda dhe jashtë klase;	Vlerësim për të nxënë (Vlerësim formues) vlerësimi i përgjigjeve me gojë; vlerësimi i punës në grup;	Materiale nga interneti; Materiale nga enciklopedi;
3.		Vlefshmëria e të dhënave në formular	Ndërton formularë duke vendosur kodin për verifikimin e vlefshmërisë së të dhënave.	Metoda integruese; Bashkëbisedim; Teknika që zhvillojnë mendimin kritik dhe krijues;	vlerësim mes nxënësish; vlerësim i aktivitetit gjatë debatoreve në klasë; vlerësim i detyrave të shtëpisë; vetëvlerësim; intervistë me një listë treguesish; vëzhgim me një	Tekst nga fusha të tjera; Slide/materiale të krijuara nga mësuesit; Modele të detyrave nga nxënësit; Makina llogaritëse etj.
4.		Gjuha e programimit PHP	PHP, një gjuhë jo tipike e cila lejon përdoruesin të krijojë faqe dinamike, që komunikojnë me bazat e të dhënave.	Prezantime në forma të ndryshme TIK; Projekte kurrikulare; Konkurse.		

(6 orë)
Programimi në Web

							listë të plotë treguesish, portofol, prezantim me gojë ose me shkrim, projekt kurrikular.
				Metoda GET e programimit <i>PHP</i>	Përpunon të dhënat e formularëve me metodën <i>GET</i> .		
6.			Metoda POST e programimit <i>PHP</i>	Përpunon të dhënat e formularëve me metodën <i>POST</i> .			
7.			Përbërësit e programit <i>Visual Basic</i>	Elementët përbërës të dritares së <i>Visual Basic</i> .			
8.			Ndryshoret dhe operatorët aritmetikë në <i>VB</i>	Kryen veprime të ndryshme si me ndryshore, numra dhe tekst.			
9.			Zbatimi i cikleve në <i>VB</i>	Shkruan një program që i kërkon kompjuterit të kryer një detyrë të caktuar.			
10.			Krijimi dhe zbatimi i një programi të thjeshtë.	Përdor elementet e toolbox-it për ndërtuar aplikacione të ndryshme për përdoruesin.			
11.			Projekt (ora e dytë). “Integrimi i bazave të të dhënave nga një aplikacion në <i>Visual Basic</i> ”.	Detyrë krijuese, krijojnë produkte digjitale.			
12.			Test për tre mujorin (linjat I, II, tre mujori i II)				

Programimi dhe Algoritmitika
(Visual Basic) 6 orë

PLANIFIKIMI 3-MUJOR (PRILL – QERSHOR)
FUSHA: TIK
LËNDA: TIK

Tematika: Programimi dhe Algoritmika (aplikimi i formulave bazë)

Përshkrimi i tematikës

Në këtë tematikë do të përqendrohemi te zhvillimi i aplikacioneve në *Visual Basic*. Do të shohim se si krijohen projektet në *VB*, se si ndërtohen programe të thjeshta në të, duke përdorur variablat dhe operatorët aritmetikë, logjikë, krahasues dhe bulean të kësaj gjuhe. Disa funksione të gatshme në *VB*, si *MsgBox* dhe *InputBox*, do t'i trajtojmë me anë të shembujve dhe do të shpjegojmë se si mund të krijoni ju vetë funksionet tuaja. Në fund, do të tregojmë se si mund të përpunohen të dhënat e ruajtura në bazat e të dhënave, në saje të programeve të krijuara në *VB*.

Rezultatet e të nxënit për kompetencat e fushës:

- **kreativiteti dhe inovacioni duke përdorur teknologjinë:** përdor kompjuterin për të zhvilluar të menduarit krijues dhe konstruktiv apo për të nxitur inovacionin dhe kreativitetin;
- **kërkimi dhe gjetja e informacionit:** përcakton strategjinë e kërkimit të informacionit duke përdorur kompjuterin; gjen, organizon, analizon, vlerëson, përpunon dhe përdor informacionin nga një shumëllojshmëri e burimeve dhe mediave; përzgjedh burimet e informacionit apo mjetet digjitale, bazuar në përshatshmërinë e tyre për kryerjen dhe zgjidhjen e një sërë detyrash;
- **mendimi kritik, zgjidhja e problemit dhe vendimmarrja:** vlerëson sistemet e informacionit dhe zgjidhjet e tyre në termat e mbledhjes së kërkesave, të reja dhe qëndrueshmërisë;
- **operacionet bazë dhe konceptet teknologjike:** shpjegon se si sistemet e informacionit dhe zgjidhjet e tyre përbushin nevojat duke marrë parasysh qëndrueshmërinë.

Tematika: Gjuha e programimit JAVA

Përshkrimi i tematikës

Në këtë tematikë, do të përqendrohemi te zhvillimi i programeve në gjuhën e programimit *Java*. Do të shohim se si mund të krijojmë programe, për të zgjidhur probleme të ndryshme të botës reale.

Java është një gjuhë programimi e orientuar në objekte dhe ne do të trajtojmë konceptin e klasave dhe të objekteve.

Nëpërmjet shembujve do të trajtojmë krijimin dhe përdorimin e objekteve në *Java*, përdorimin e strukturëve dhe krijimin e projekteve në *Java*.

Rezultatet e të nxënit për kompetencat e fushës:

Nxënësit:

- punojnë me një komunitet *online* për të arritur një qëllim të përbashkët kërkimor;
- krijojnë, promovojnë dhe paraqesin një transmetim për një audience të gjerë.

Nr	Kapitulli	Temat mësimore	Situata e parashikuar e të nxënit	Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve	Vlerësimi	Burimet
1.	Programimi në Web (4 orë)	Funksionet në VB	Përdor funksionet për të realizuar një dialogim midis përdoruesit dhe kompjuterit.	Metoda interaktive, bashkëvepruese, diskutime gjithëpërfshirëse;	Vlerësim diagnostikues, intervistë me një listë treguesish;	Teksti i TIK për klasën e XI ,pajisje fundore, media;
		Ndërtimi i funksioneve	Ndërton një funksion që dëshiron në VB.	Puna në grup dhe puna individuale;	vetëvlerësim me listë kontrolli.	Teksti i mësuesit për klasën e XI;
		Integrimi i bazave të të dhënave në VB	Lidhja e aplikacionit në VB me bazën e të dhënave MS Access duke përdorur kontrollin e të dhënave ADO.	Hetimi dhe zbulimi;	Vlerësim për të nxënë (Vlerësim formues) vlerësimi i përgjigjeve me gojë; vlerësimi i punës në grup;	Materiale nga interneti;
		Përdorimi i bazave të të dhënave nga një aplikacion në VB	Leximi dhe modifikimi i bazave të të dhënave të përfshira në VB.	Zbatime praktike brenda dhe jashtë klase;	Metoda integruese;	vlerësim mes nxënësish; vlerësim i aktivitetit gjatë debateve në klasë;
5.	Krijimi i klasave në Java	Krijoni një program të thjeshtë në Java, duke zbatuar konceptet e programimit nga klasa (class).	Bashkëbisedim;	Teknika që zhvillojnë mendimin kritik dhe krijues;	Tekst nga fusha të tjera;	Slide/materiale të krijuara nga mësuesit;
		Vetitë e klasave në Java	Llojet e variablave, rregullat shkrimit të variablave; kryerja e veprimeve dhe prioriteti i veprimeve.	Prezantime në forma të ndryshme TIK;	intervistë me një listë treguesish; vëzhgim me një listë të plotë treguesish, portofol,	Modele të dehydrave nga nxënësit;
7.	Gjuhë e programimit JAVA (8 orë)	Zgjidhja e problemeve nëpërmjet programeve në Java	Problemat që zgjidhen në bazë të kushteve if; if...else; switch...case; for;while; do...while.	Projekte kurrikulare; Konkurse.	prezantim me gojë ose me shkrim, projekt kurrikular.	Makina llogaritëse etj.

8.	Klasat në Java	<i>Krijimi i objekteve dhe klasave në Java.</i>		
9.	Objektet në Java. Konstruktorët dhe destrukturët	<i>Krijimi i objekteve nëpërmjet konstruktorëve në Java.</i>		
10.	Vlerësimi i portofolit personal			
11.	Projekt (ora tretë). “Integrimi i bazave të dhënave nga një aplikacion në Visual Basic”.	<i>Detyrë krijuese, krijojnë produkte digjitale.</i>		
12.	Test për tre-mujorin (linjat I, II, tre-mujori i III)			

Tematika 1: Bota e kompjuterit**PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE**

Dt. / /

Fusha: TIK	Lënda: TIK	Shkalla: V	Klasa: XI Ora:
Tema mësimore 1.1: Siguria e rrjetit dhe rëndësia e saj. Kriptografia		Situata e të nxënit Askush nga ne nuk e vë në dyshim dobinë që marrim nga kompjuteri, aq më tepër nga një kompjuter i lidhur në Internet! Duke pasur në konsideratë faktin që të gjithë kërcënuesit kanë për synim një qëllim siç është ai i cenimit të dobive që gjeneron një kompjuter, biem dakord se po aq sa teknikisht është i avancuar kompjuteri, kërkohet që edhe përdoruesi i tij të posedojë njohuritë e duhura! Shpjegoni pse është e rëndësishme që burimet e rrjetit të mbrohen? Çfarë masash paraprake duhet të ndërmerren nga një individ, shoqëri biznesi apo dhe organizatë që të dhënat të mos përdoren nga persona të pa autorizuar?	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç: <ul style="list-style-type: none"> • vlerëson sigurinë e rrjetit; • eksploron burime mësimore TIK; • njeh komponentët e sigurisë të rrjetit; • vlerëson teknikat e mbrojtjes së rrjetit. 		Fjalët kyç: Identifikim, Autentifikim, Autorizim, Kriptografi, IPsec, Firewall, VPN, Siguria Wireless.	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: <ul style="list-style-type: none"> • vlerëson rëndësinë e sigurisë në rrjet; • njeh kërcënimet që vijnë nga rrjeti; • njeh proceset që garantojnë siguri në rrjet. 		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurikulare: Gjuhët dhe komunikimi, ekonominë, historinë etj.	
Burimet: Libri mësimor, kompjuteri dhe interneti, historia.		Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: mësimdhënie e drejtpërdrejtë.	
Organizimi i orës së mësimi Mësuesi shtron çështjen e marrjes së vendimit për të vendosur siguri në një mjedis të caktuar pune. Ai thekson se, gjëja e parë që do të bëjmë është të vlerësojmë kërcënuesit potencialë të një mjedisi të tillë pune, duke lënë të kuptohet se e njëjta gjë vlen edhe për sigurinë e rrjeteve kompjuterike.			

Përmes identifikimit të kërcënuesve të mundshëm të rrjetit kompjuterik, ne rrisim shanset që të gjejmë zgjidhjen më të mirë të mundshme për siguri të rrjetit kompjuterik. Në rastin e vendosjes së sigurisë në rrjete kompjuterike duhet të dimë se çfarë është siguria e rrjeteve kompjuterike dhe si implementohet ajo?

Sipas fjalorit *Webster*, siguria në përgjithësi definohet si “gjendje ose cilësi e të ndjerit i lirë nga frika, shqetësimi ose përkujdesi”.

Në ditët e sotme, vërejmë numër të madh të teknologjive të përdorura nga bizneset për të siguruar rrjetet e tyre kompjuterike.

Mësuesi shtron pyetjen: *Nëse kërcënimi për shërbimet ne rrjete kompjuterike vjen gjithmonë nga jashtë apo ka diçka me shumë se kaq?*

Ajo/ai sqaron masat e sigurisë që duhet të ndërmerren siç janë identifikimi, autorizimi dhe autentifikimi.

Sqaron këto tri procese duke iu referuar një shembulli konkret:

- Ju ka ndodhur të jeni me prindin tuaj kur kanë tërhequr para pranë një bankomati? Nëse, po prindi juaj ka vendosur një kartë në bankomat që ka një nr. të caktuar p.sh., 1111 0110 2546 4578 , sa herë ai e vendos kartën e tij në bankomat, realizon procesin e identifikimit. Shtypja e kodit (pin) p.sh., 0245 është një proces që quhet autorizim; nëse të dy proceset nuk kanë probleme, bankomati i jep mundësi prindit tuaj të tërheqë një shumë të caktuar, ky proces quhet autentifikimi.

Këto tri procese janë të zbatuara në rrjetet kompjuterike për të garantuar sigurinë dhe janë disa pajisje apo programe të ndryshme që janë përgjegjëse për secilin prej tyre.


Mësuesi/ja shkruan në tabelë konceptet: *Kriptografi, Internet Protocol Security, Firewall, Virtual Protocol Network, Siguria Wireless.*


Fton nxënësit për të diskutuar nga përvojat e tyre ose nga informacioni që ata kanë për këto koncepte.

Gjatë këtij diskutimi nxënësit prezantojnë njohuritë e tyre në lidhje me kriptografinë duke iu referuar atyre ç’ka mund të kenë lexuar apo dëgjuar në media apo edhe në internet apo në biseda të lira.

Plotësohet harta e njohurive në mënyrë skematike (bllok-skemë, kllaster, letra ngjitëse).

Në fund me ndihmën e nxënësve bëhet një përmbledhje e mbi sigurinë e rrjetit dhe rëndësinë e tij, duke i paraqitur grafikisht me kllaster.





Kompetencat që përfitojnë: kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit, kompetenca digjitale.

Vlerësimi bëhet për:

- diskutimet dhe argumentet që sjellin;
- lidhjen e pjesës me përvoja nga njohuritë e fituara më parë;
- detyrat e kryera në shtëpi apo edhe në klasë;
- bashkëpunimin në grupe;
- vlerësimin që i bëjnë njëri-tjetrit.

Detyrat dhe puna e pavarur:

- ☞ Kërkoni në internet disa nga teknikat dhe teknologjitë e disponueshme në ditët e sotme, për të siguruar intimitetin individual si dhe shërbimet në rrjetet kompjuterike të bizneseve.
- ☞ Bëni një hulumtim në *web* mbi përdorimin e kriptografisë dhe mbi ndikimin e saj në historinë botërore. Diskutojini ato me shokët e klasës

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. / /

Fusha: TIK	Lënda: TIK	Shkalla: V	Klasa: XI
			Ora:
Tematika III: Programimi në Web Tema mësimore: Funkcionet kryesore në Javascript		Situata e të nxënit: Vendos ngjarjen e duhur në elementet <i>HTML</i> sipas sintaksës së duhur dhe realizon një ngjarje në <i>HTML</i> duke përdorur vetitë e JS.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe – zhvillon aftësi, qëndrime dhe njohuri për funksionet e ngjarjeve në <i>Javascript</i> .			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi: – njeh funksionet kryesore të <i>Javascript</i> -it; – kupton çfarë konsiderohen ngjarje(<i>Event</i>) në <i>Javascript</i> ; – diskuton mbi parimet e programimit me <i>Jquery</i> .		Fjalët kyçe: -Ngjarje, <i>event handler</i> ; - <i>Jquery</i> .	
Burimet: Libri i nxënësit; kompjuter; projektor digjital.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Argëtim; gjuhë programimi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			

Organizimi i orës së mësimit

a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme. Metoda: Punë përgatitore

Gjatë realizimit të kësaj teme mësuesi/ja fton nxënësit për të diskutuar nga përvojat ose nga informacioni që ato kanë për vendosjen e një funksioni në JS. Mësuesi/ja ka përgatitur paraprakisht në çdo kompjuter të nxënësve kodin se si një përdorues ndërvepron me një faqe *web*-i.

```
<html><head>
<script type="text/javascript">
function displaymessage() {
alert("NGJARJA!");
}
</script>
</head>
<body>
<form>
<input type="button" value="Kliko ketu"
onclick="displaymessage()" />
</form>
<p>Duke shtypur butonin me lart do te therras funksioni.</p>
</body></html>
```

b. Ndërtimi i njohurive të reja. Metoda: Vepërtari e drejtuar

Funksioni që thirret, kur ndodh një ngjarje, njihet si *event handler*. Mësuesi/ja thekson se ngjarjet dhe mbartësit e tyre i bëjnë aplikacionet e tyre *web* më dinamike dhe më ndërvepruese. Në monitor mësuesi/ja paraqet funksionet që trajtojnë ngjarjet e mausit, tastierës dhe dritares *web*.

Në bashkëpunim me nxënësit demonstrojnë shembullin për shkrimin e një funksioni në JS, që ngarkon të dhënat e një formulari.

Mësuesi/ja u tregon nxënësve që *Jquery* është një bibliotekë funksionesh e cila bën manipulimin e *HTML*-së, të *event handler*-ave, animacioneve dhe shkëmbimin e të dhënave shumë herë më thjeshtë me anë të një API të lehtë për t'u përdorur, që punon me një numër të madh *browser*-ash.

Parimet e e programit me *Jquery* janë:

- a- ndarja e JS-it me *HTML*-në;
- b- më pak kod dhe më i qartë;
- c- eliminimi i papajtueshmërisë mes *browser*-ave.

c. Prezantim dhe demonstrim i rezultateve të arritura. Metoda: Punë e pavarur

Nxënësit punojnë në grupe dyshe ushtrimin 1, 3,4 fq. 42.

Vlerësimi: Ora do të quhet e suksesshme nëse nxënësi:

- kupton çfarë konsiderohen ngjarje (*Event*) në *Javascript* dhe diskuton mbi parimet e programimit me *Jquery*.

Të vlerësohet gjithashtu dhe puna e bërë në grupe dyshe dhe bashkëpunimi midis nxënësve, duke marrë në konsideratë kontributin e secilit nxënësi.

Detyrë shtëpie: Ushtrimi 2 fq. 42

Fusha: Teknologji/TIK	Lënda: TIK	Shkalla: V	Klasa: 11
Tematika III: Programimi në Web Tema mësimore: Vlefshmëria e të dhënave në formular		Situata e të nxënësve: Ndërton formularë duke vendosur kodin për verifikimin e vlefshmërisë së të dhënave.	
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe: <ul style="list-style-type: none"> – zhvillon aftësi, qëndrime dhe njohuri për shkrimin e kodit për verifikimin e vlefshmërisë së të dhënave në formularët. 			
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> – identifikon si tekst konceptin vlefshmëria e të dhënave; – shpjegon mënyrat e verifikimit e vlefshmërisë së të dhënave në JS; – shkruan kodin për verifikimin e vlefshmërisë së të dhënave në formularët. 		Fjalët kyçe: -vlefshmëria e të dhënave; -verifikimi i vlefshmërisë së të dhënave.	
Burimet: Libri i nxënësit; kompjuter; projektor digjital.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Argëtim; gjuhë programimi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
<p style="text-align: center;">Organizimi i orës së mësimi</p> <p>a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme. Metoda: Punë përgatitore Mësuesi/ja u kërkon nxënësve të shkruajnë kodin në <i>HTML</i> për formularin në figurën 1 fq. 43. Kodi duhet të jetë si më poshtë:</p> <pre><html> <body> <form method="post" action="mailto:info@emailjone.com"> Name: <input type="text" size="10" maxlength="40" name="Emri">

 Fjalekalimi: <input type="fjalekalimi" size="10" maxlength="10" name="fjalekalimi">

 <input type="submit" value="Regjistrohu"> </form> </body> </html></pre> <p>Mësuesi/ja u kërkon nxënësve të tregojnë se cili është tag-u në <i>HTML</i> që lejon të përfshihet një kod në JS që përdoruesi të lejohet të plotësojë fushat e formularit.</p> <p>b. Ndërtimi i njohurive të reja. Metoda: Veprimtari e drejtuar Mësuesi/ja ju drejton pyetje nxënësve nëse kanë hapur një adresë <i>email</i>-i apo nëse kanë plotësuar një formular <i>online</i>. Nëse po, pasi e keni plotësuar, ju është kërkuar që formulari të përsëritet me informacion të saktë?</p>			

Vlefshmëria e të dhënave është procesi që siguron se të dhënat e futura nga përdoruesi janë të sakta dhe të dobishme. Detyrat tipike të verifikimit të vlefshmërisë së të dhënave janë:

- plotësimi i të gjitha fushave të kërkuara;
- të dhënat e futura nga përdoruesi të jenë të dhëna të vlefshme.

Verifikimit të vlefshmërisë së të dhënave mund të bëhet me dy mënyra:

1. Në anën e serverit.
2. Në anën e klientit.

Mësuesi/ja demonstroi në bashkëpunim me nxënësit verifikimin e vlefshmërisë së të dhënave në JS duke përdorur shembullin në fq. 44, i cili kryhet nga vlerësimi bazë dhe vlerësimi i formatit të të dhënave.

c. Prezantim dhe demonstrim i rezultateve të arritura. Metoda: Punë e pavarur
 Nxënësit punojnë në grupe dyshe ushtrimin 1, 2 fq. 45.

Vlerësimi: Ora do të quhet e suksesshme nëse nxënësi:

- liston detyrat tipike të vlefshmërisë e të dhënave;
- shpjegon mënyrat e verifikimit e vlefshmërisë së të dhënave në JS.

Të vlerësohet gjithashtu dhe puna e bërë në grupe dyshe dhe bashkëpunimi midis nxënësve, duke marrë në konsideratë kontributin e secilit nxënësi.

Detyrë shtëpie: Krijoni një formular për të pranuar kursantë të rinj në kursin e tenisit, duke vendosur kodin për verifikimin e vlefshmërisë së të dhënave.

Fusha: Teknologji/TIK	Lënda: TIK	Shkalla: V	Klasa: 11
<p>Tematika III: Programimi në Web</p> <p><i>Tema mësimore: Gjuha e programimit PHP</i></p>		<p>Situata e të nxënit: PHP, një gjuhë jo tipike e cila lejon përdoruesin të krijojë faqe dinamike, që komunikojnë me bazat e të dhënave.</p>	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</p> <ul style="list-style-type: none"> – zhvillon aftësi, qëndrime dhe njohuri për gjuhën PHP si gjuhë programimi nga ana e serverit. 			
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> – evidenton veçoritë e gjuhës PHP; – tregon për PHP si gjuhë programimi nga ana e serverit; – shkruan një program të thjeshtë në PHP. 		<p>Fjalët kyçe:</p> <p>-PHP.</p>	
<p>Burimet: Libri i nxënësit; kompjuter; projektor digjital.</p>		<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Argëtim; gjuhë programimi.</p>	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Organizimi i orës së mësimimit

a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme. Metoda: Thuaj dhe trego

Gjatë realizimit të kësaj teme mësuesi/ja fton nxënësit për të diskutuar nga përvojat ose nga informacioni që ato kanë për gjuhën PHP. Nga ndryshon një faqe statike nga një faqe dinamike? Gjatë këtij diskutimi nxënësit/et lexojnë shembullin në fq. 46 dhe duhet të dallojnë se një klient mund të lexojë vetëm kodet html, ndërsa serveri është në gjendje të lexojë PHP.

b. Ndërtimi i njohurive të reja. Metoda: Bazuar në kërkim

Mësuesi/ja thekson se PHP është pjesë e gjuhëve server-side dhe në pamundësi të një server në kompjuterin tuaj mund të instaloni paketat WAMP ose XAMP, që kanë të bëjnë me *webserver*-in *Apache*, *MySQL*.

Në bashkëpunim me nxënësit/et listojmë në tabelë të zezë veçoritë e gjuhës PHP.

A njihni ndonjë platformë që është ndërtuar mbi bazën e gjuhës PHP? P.sh.: *Wordpress*, *Facebook*, *Joomla*.

Si mund të krijojmë një skedar në gjuhën PHP dhe të rezervohet në kompjuter? Demonstrim në projektor shembullin 1 fq. 47 dhe sqarojmë që kodet e shkruara në PHP duhet të vendosen gjithmonë në kllapa midis bllokut `<?php...?>` dhe se një ka funksionet më të përdorura është *echo*. Skedarin e rezervojmë në formatin **index.php**

Në bashkëpunim me nxënësit realizon shembullin 2 fq. 47 duke dhënë sqarimet përkatëse.

c. Prezantim dhe demonstrim i rezultateve të arritura. Metoda: Bazuar në detyrë

Kontrolloni njohuritë 1,2,3 fq. 47.

Vlerësimi: Ora do të quhet e suksesshme nëse nxënësi:

- shkruan një program të thjeshtë në PHP dhe shpjegon pse PHP është një gjuhë jo tipike.

Fusha: Teknologji/TIK	Lënda: TIK	Shkalla: V	Klasa: 11
Tematika III: Programimi në WEB <i>Tema mësimore: Metoda GET në PHP</i>		Situata e të nxënit: përpunon të dhënat e formularëve me metodën GET.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: – zhvillon aftësi, qëndrime dhe njohuri për të përpunuar të dhënat me metodën GET.			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi: – liston mënyrat e dërgimit të informacionit në <i>Webserver</i> nga klienti; – dallon metodën GET nga metoda POST; – përdor metodën GET për të dërguar të dhënat në server.		Fjalë kyçe -Metoda GET, Metoda POST	

Burimet: Libri mësitor; kompjuter; projektor digjital; internet.	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Argëtim; gjuhë programimi.
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve	
<p style="text-align: center;">Organizimi i orës së mësimit</p> <p>a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme. Metoda: Thuaj dhe trego</p> <p>Mësuesi/ja pyet nxënësit se përse gjuha PHP është një gjuhë jo tipike. Cilat janë disa nga platformat që ju njihni të cilat janë të shkruara në gjuhën PHP. Kërkoni në internet se cilat janë aplikacionet më të përdorura në <i>Facebook</i>, të cilat janë të shkruara gjithashtu në PHP. Krijoni një program të thjeshtë për regjistrimin në kursin e notit.</p> <p>b. Ndërtimi i njohurive të reja. Metoda: Bazuar në kërkim</p> <p>Mësuesi/ja thekson që një klient të dërgojë informacione në <i>webserver</i> duhet të përdorë metodën GET ose POST. Këto dy metoda janë përdorur për të njëjtin qëllim por me metodën GET, të dhënat kalohen nëpërmjet <i>URL</i>-së, ndërsa në POST, transferimi i informacionit bëhet në mënyrë të fshehtë.</p> <p>Sintaksa e përdorur paraqitet si më poshtë:</p> <pre><form method="POST"> <form method="GET"> </form> </form></pre> <p>A keni vënë re më përpara një URL shumë të gjatë, ku pjesa e fundit mund të jetë e tillë: ?name=john&email=john@gmail.com&contact=987654985456</p> <p>Çfarë kuptimi ka për ju?</p> <p>Mësuesi/ja jep sqarimet përkatëse që shenja ? tregon që përdoruesi po dërgon të dhëna, dhe se përdoruesi ka plotësuar një formular me fusha të tilla si emri, adresa e <i>email</i>-it dhe numri i kontaktit.</p> <p>Demonstron në bashkëpunim me nxënësit përdorimin e metodës GET, për të dërguar të dhëna në server.</p> <p>c. Prezantim dhe demonstrim i rezultateve të arritura. Metoda: Bazuar në detyrë</p> <p>Nxënësit punojnë në grupe dyshe te <i>Kontrolloni njohuritë</i> 1-4 fq. 50.</p>	
<p>Vlerësimi: Kjo orë do të quhet e realizuar nëse nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> – dallon metodën GET nga POST dhe përdor metodën GET për të dërguar të dhënat në server. <p><i>Vlerësohet gjithashtu dhe puna e bërë në grupe dyshe dhe bashkëpunimi midis nxënësve, duke marrë në konsideratë kontributin e secilit nxënësi.</i></p> <p>Detyrë shtëpie: Shkruani kodin PHP që përpunon të dhënat e një formulari për ndjekjen e studimeve universitare.</p>	

Fusha: Teknologji/TIK	Lënda: TIK	Shkalla: V	Klasa: 11
Tematika III: Programimi në WEB Tema mësimore: Metoda POST e programimit PHP		Situata e të nxënit: përpunon të dhënat e formularëve me metodën POST.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: – zhvillon aftësi, qëndrime dhe njohuri për të përpunuar të dhënat me metodën GET.			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi: – dallon metodën GET nga metoda POST; – përdor metodën POST për të dërguar të dhënat në server; – diskuton se cila nga metodat GET apo POST duhet të përdorim për përpunimin e të dhënave të formularëve.		Fjalë kyçe: -Metoda POST.	
Burimet: Libri mësimor; kompjuter; projektor digjital.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Argëtim; gjuhë programimi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Organizimi i orës së mësimi			
<p>a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme. Metoda: Punë përgatitore Gjatë realizimit të kësaj teme mësuesi/ja fton nxënësit për të diskutuar nga përvojat ose nga informacioni që ata kanë për gjuhën PHP dhe pse ajo konsiderohet një gjuhë jo tipike. Nxënësit punojnë në grupe dyshe për ndërtimin e formularit në gjuhën HTML dhe PHP me fushat përkatëse <i>NAME</i>, <i>Email</i>, dhe butonit <i>Submit</i> dhe të përpunojnë të dhënat me metodën GET. Shpjego URL-në ?name=Tomi&email=tomi@gmail.com</p> <p>b. Ndërtimi i njohurive të reja. Metoda: Veprimtari e udhëhequr Mësuesi/ja pyet nxënësit se çfarë metode duhet të përdorim nëse transferimin e informacionit duhet ta bëjmë në mënyrë të fshehtë. Pasi merr mendimet e nxënësve mësuesi/ja thekson se metoda POST përdoret për dërgimin e informacioneve të ndjeshme në server, si për shembull <i>password</i>, <i>username</i> ose informacione të detajuara të përdoruesit. Mësuesi/ja pyet nxënësit për veçoritë e metodës GET dhe në analogji me të u tregon për veçoritë e metodës POST.</p> <p>Njëkohësisht me nxënësit mësuesi/ja shkruan kodin <i>HTML</i> dhe <i>PHP</i> të përfshirë në të njëjtin skedar file note.php. Në fund nxënësit duhet të venë re se në rastin e metodës POST, nuk kemi një <i>query string</i>, ku të shfaqen të dhënat që përdoruesi ka vendosur nga tastiera.</p>			

c. Prezantim dhe demonstrim i rezultateve të arritura. Metoda: Puno në grupe dyshe

Nxënësit punojnë në grupe dyshe te *Kontrolloni njohuritë* 1,2 fq. 52.

Nxënësit plotësojnë tabelën e mëposhtme me njohuritë marra duke bërë dallimin midis metodës GET dhe POST:

Dërgimi i informacioneve në server		
	Metoda GET	Metoda POST
Sintaksa	Psh<form method="GET"> </form>	<form method="POST"> </form>
Veçoritë	- Të dhënat kalojnë nëpërmjet URL-së - Është e kufizuar për të dërguar më shumë se 1024 shenja	- Transferimi i informacionit bëhet në mënyrë të fshehtë. - Nuk ka ndonjë kufizim të madhësisë së të dhënave që do të dërgohen.

Vlerësimi: Kjo orë do të quhet e realizuar nëse nxënësi:

- tregon për veçoritë e metodës POST dhe përpunon të dhënat e formularëve me metodën POST.

Fusha: Teknologji/TIK	Lënda: TIK	Shkalla: V	Klasa: 11
Tematika III: Programimi dhe Algoritmika <i>Tema mësimore: Përbërësit e programimit Visual Basic</i>		Situata e të nxënët: Elementet përbërëse të dritares së <i>Visual Basic</i> .	
Rezultatet e të nxënët sipas kompetencave kyçe: - zhvillon aftësi, qëndrime dhe njohuri për elementet e dritares së punës së <i>Visual Basic</i> .			
Rezultatet e të nxënët të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi: - njihet me përbërësit e <i>Visual Basic</i> ; - krijon një projekt në <i>Visual Basic</i> .		Fjalë kyçe: - <i>Visual Basic</i> .	
Burimet: Libri mësimor; kompjuter; projektor digjital; internet; letër A4.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Argëtim, gjuhë programimi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Organizimi i orës së mësimit			
a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme. Metoda: Punë përgatitore Mësuesi/ja pyet nxënësit se çfarë dinë për Mjediset e integruara të zhvillimit (<i>Integrated Development Environments</i>). Cilët nga IDE-të keni përdorur? Demonstroj në bashkëpunim me nxënësit shkarkimin nga interneti të programit <i>Visual Studio 2015</i> .			

b. Ndërtimi i njohurive të reja. Metoda: Veprimtari e udhëhequr

Mësuesi/ja kontrollon nëse të gjithë nxënësit e kanë shkarkuar programin në kompjuterat e tyre. Demonstron njëkohësisht me nxënësit hapjen e programit *Visual Studio 2015*, klikon në menynë *File* dhe zgjedh *New Project -Visual Basic -Windows Forms Application*.

Mësuesi/ja sqaron konkretisht dritaren kryesore të *Visual Studio* për projektet e VB.

- ✓ *Title Bar* – emri i projektit
- ✓ *Menu Bar* – shiriti i menyve (*File, Edit, View, Project* etj.,)
- ✓ *Toolbox* – mjetet për krijimin e formularit
- ✓ *Solution Explorer Windows* – tregon direktorinë ku ndodhet projekti dhe të gjithë skedarët që përmban ai.
- ✓ *Properties* – shërben për të paraqitur të gjitha vetitë e objekteve të përzgjedhura në formular.
- ✓ *Form Design* – kjo është dritarja jonë ku vendosim të gjitha elementet e *Toolbox*-it, për të ndërtuar aplikacionin tonë.

c. Prezantim dhe demonstrim i rezultateve të arritura. Metoda: Puno në grupe dyshe/pavarur

Kontrolloni njohuritë 1-3 fq. 56.

Mësuesi/ja ka përgatitur paraprakisht në një fletë A4 dritaren kryesore të *Visual Studio* për projektet në VB, ku secili nxënës e plotëson me njohuritë e marra gjatë kësaj ore mësimi.

Vlerësimi: Kjo orë do të quhet e realizuar nëse nxënësi:

- njeh elementet përbërëse të dritares së *Visual Basic* dhe krijon një projekt.

Të vlerësohet gjithashtu dhe puna e bërë në grupe dyshe dhe bashkëpunimi midis nxënësve, duke marrë në konsideratë kontributin e secilit nxënës.

Fusha: Teknologji/TIK	Lënda: TIK	Shkalla: V	Klasa: 11
Tematika III: Programimi dhe Algoritmika Tema mësimore: Ndryshoret dhe operatorët aritmetikë		Situata e të nxënit: kryen veprime të ndryshme si me ndryshore, numra dhe tekst.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: <ul style="list-style-type: none"> – zhvillon aftësi, qëndrime dhe njohuri për të përdorur operatorët aritmetikë, krahasues dhe logjikë si dhe është në gjendje të fus ndryshoret në program. 			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> – është në gjendje të fusë ndryshoret në program; – mëson të përdorë operatorët aritmetikë, krahasues dhe logjikë. 		Fjalë kyçe: -ndryshoret, vlerëdhënie, operatorët aritmetikë.	
Burimet: Libri mësimor; kompjuter; projektor digjital; internet; letër A4.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Argëtim; gjuhë programimi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			

Organizimi i orës së mësimit

a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme. Metoda: Thuaj dhe trego

Mësuesi/ja pyet nxënësit se çfarë dinë për konstantet dhe ndryshoret? Nga se karakterizohen ato? Diskutoni me shokët e klasës rreth informacioneve që mund të keni rreth tyre.

b. Ndërtimi i njohurive të reja. Metoda: Bazuar në kërkim

Mësuesi/ja ka marrë përgjigjet e nxënësve dhe shkruan në tabelë sintaksën për të deklaruar një ndryshore:

```
Dim Emri i ndryshores As lloji i ndryshores
```

Ku *Dim* është fjala kyçe, e cila tregohet se po deklarohet një ndryshore (gjithmonë para se të përdoret).

Emri i ndryshores është emri që i është caktuar ndryshores (mësuesi/ja tregon rregullat e dhëna për emërtimin e ndryshores).

Lloji i ndryshores përcakton llojin e të dhënave (mësuesi/ja tregon llojet e ndryshme të të dhënave).

Shembuj:

Dim tekst *As* String

Dim numër *As* Integer

Dim numërPresje *As* Double

Dim numër1,numër2,numër3 *As* Integer,

Dim numër1,numër2 *As* Integer,tekst1,tekst2 *As* String

Në qoftë se duam që ndryshorit numër të deklaruar t’i japim një vlerë, ky proces quhet vlerëdhënie p.sh.:

```
Dim numër As Integer
numër =3
numër =5
```

Mësuesi/ja pyet nxënësit se çfarë kuptojnë me operatorë? Shkruan në dërrasë të zezë tabelën e mëposhtme dhe plotësohet në bashkëpunim me nxënësit.

Operatorët aritmetikë	Operatorët racional	Operatorët logjike
*,/,%,+,-	==,!=,>,>=,<,<=	!,&&, ,^

Demonstroj përdorimin e operatorëve aritmetikë në VB.

c. Prezantim dhe demonstrim i rezultateve të arritura. Metoda: Bazuar në detyrë Kontrolloni njohuritë 1,2 fq. 59.

Mësuesi/ja ka përgatitur paraprakisht në një fletë A4 një tabelë me operatorët logjike.

Vlera e shprehjes logjike A	Vlera e shprehjes logjike B	!A	A&&B	A B	A^B
e vërtetë	e vërtetë				
e vërtetë	e gabuar				
e gabuar	e vërtetë				
e gabuar	e gabuar				

Vlerësimi: Kjo orë do të quhet e realizuar nëse nxënësi:

- kryen veprime të ndryshme si me ndryshore, numra dhe tekst, duke përdorur operatorët aritmetikë, krahasues dhe logjikë.

Të vlerësohet gjithashtu dhe puna e bërë në grupe dyshe dhe bashkëpunimi midis nxënësve, duke marrë në konsideratë kontributin e secilit nxënësi.

Fusha: Teknologji/TIK	Lënda: TIK	Shkalla: V	Klasa: 11
Tematika III: Programimi dhe Algoritmika Tema mësimore: Zbatimi i cikleve në VB		Situata e të nxënit: Shkruan një program që i kërkon kompjuterit të kryer një detyrë të caktuar.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: – zhvillon aftësi, qëndrime dhe njohuri për përdorimin e cikleve në <i>Visual Basic</i> .			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi: – shkruan sintaksën e <i>if, Select Case, For dhe While;</i> – njeh dhe zbaton ciklet në <i>Visual Basic</i> .		Fjalë kyçe: <i>-if, Select Case, For dhe While.</i>	
Burimet: Libri mësimor; kompjuter; projektor digjital.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Argëtim; gjuhë programimi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Organizimi i orës së mësimi			
a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme. Metoda: Punë përgatitore U kërkoj nxënësve të hapin programin <i>Visual Studio</i> dhe të krijojnë një projekt në <i>Visual Basic</i> . Shkruani programin për gjetjen e sipërfaqes së rrethit, nëse përdoruesi do të shtyp butonin “Llogarit sipërfaqen”. Tregoni cilat nga mjetet e <i>toolbox</i> përdorët?			
b. Ndërtimi i njohurive të reja. Metoda: Veprimtari e udhëhequr Në programin e realizuar vihet re përdorimi i kushtit <i>IF...ELSE</i> . Mësuesi/ja sqaron se përdorimi i kushteve është i rëndësishëm sepse ndihmon në marrjen e vendimeve që na ndihmon për zgjidhjen e problemeve praktike. Mësuesi/ja sqaron përdorimin e kushteve <i>IF</i> dhe <i>Select Case</i> . Demonstrohet (njëkohësisht me nxënësit) shembulli fq. 60. Pyeten nxënësit sepse kanë marrë njohuri nga klasat e mëparshme se përse shërbejnë ciklet. Mësuesi/ja thekson se çdo cikël përbëhet nga tri pjesë: kushti i ndërprerjes së ciklit, trupi i ciklit dhe kthimi në fillim të ciklit. Sqarohet sintaksa e ciklit <i>FOR</i> ndërkohë që ka përgatitur paraprakisht shembullin fq. 62 dhe e demonstroi në projektor:			

<p>FOR Ndryshorja=Vlera Fillestare To Vlera Përfundimtare Step Hapi i Ndryshores ...VB shprehjet... Next ndryshorja</p> <p>Sqarohet sintaksa e While, e cila ka dy forma ndërkohë që ka përgatitur paraprakisht shembujt fq. 63 dhe i demonstroi në projektor:</p> <p>:</p> <table style="width: 100%; border: none;"> <tr> <td style="width: 50%;">Do While (kushti)</td> <td style="width: 50%;">Do</td> </tr> <tr> <td>Grupi i shprehjeve</td> <td>Grupi i shprehjes</td> </tr> <tr> <td>Loop</td> <td>Loop While(kushti)</td> </tr> </table> <p>c. Prezantim dhe demonstrim i rezultateve të arritura. Metoda: Puno në grupe dyshe Kontrolloni njohuritë 1,2 fq. 63.</p>	Do While (kushti)	Do	Grupi i shprehjeve	Grupi i shprehjes	Loop	Loop While(kushti)
Do While (kushti)	Do					
Grupi i shprehjeve	Grupi i shprehjes					
Loop	Loop While(kushti)					
<p>Vlerësimi: Kjo orë do të quhet e realizuar nëse nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> – njeh dhe zbaton ciklet në <i>Visual Basic</i>. <p>Detyrë shtëpie: Ushtrimi 3 fq. 63</p> <p>Të vlerësohet gjithashtu dhe puna e bërë në grupe dyshe dhe bashkëpunimi midis nxënësve, duke marrë në konsideratë kontributin e secilit nxënësi.</p>						

Fusha: Teknologji/TIK	Lënda: TIK	Shkalla: V	Klasa: 11
<p>Tematika III: Programimi dhe Algoritmika Tema mësimore:</p>		<p>Situata e të nxënit: Përdor elementet e <i>toolbox</i>-it për ndërtuar aplikacione të ndryshme për përdoruesin.</p>	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:</p> <ul style="list-style-type: none"> – zhvillon aftësi, qëndrime dhe njohuri për të krijuar një aplikacion në <i>Visual Basic</i>. 			
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> – është në gjendje të krijojë një program të thjeshtë; – njeh procedurën e zbatimit të një programi. 		<p>Fjalë kyçe: -Build, Debug.</p>	
<p>Burimet: Libri mësimor; kompjuter; projektor digjital.</p>		<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Argëtim; gjuhë programimi.</p>	
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</p>			
<p>Organizimi i orës së mësimin</p>			
<p>a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme. Metoda: Punë përgatitore Mësuesi/ja u kërkon nxënësve të krijojnë një projekt VB në programin <i>Visual Studio Community 2015</i>. Ngre një nxënësi që të tregojë përbërësit e dritares së VB. U kërkon nxënësve të përdorin të gjitha elementet që ndodhen në <i>Toolbox</i>, për t'u familjarizuar sa më shumë me to.</p>			

<p>b. Ndërtimi i njohurive të reja. Metoda: Veprimtari e udhëhequr Mësuesi/ja demonstroi krijimin e elementeve në një formularë, duke përdorur Label-in dhe TextBox-in që ndodhet në <i>Toolbox</i>.</p> <p>Për secilin nga <i>Label</i>-at shkojmë te dritarja <i>Properties</i> dhe vendosim:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Te vetia Text e Label 1 shkruani “Emri juaj” dhe te vetia Font zgjedhin 12px, Bold 2. Te vetia Text e Label 2 shkruani “Fjalëkalimi” dhe te vetia Font zgjedhin 12px, Bold 3. Te vetia Text e Label 3 shkruani “Përshkruani shkurtimisht vetveten” dhe te vetia Font zgjedhin 12px, Bold <p>Për secilin nga <i>TextBox</i>-at shkojmë te dritarja <i>Properties</i> dhe vendosim:</p> <ol style="list-style-type: none"> 4. Te vetia Passwordchar e TextBox2 shkruani “*” 5. Te vetia Scrollbar e TextBox3 zgjidhni vertikal, ndërsa te vetia Multiline, zgjedhim True dhe te BackColor zgjedhim Grey. <p>Për të përpiluar programin zgjedhim menynë Build – Build Solution dhe për ta zbatuar atë për të parë rezultatet në menynë Debug klikojmë opsionin Start without debbgging dhe vendosim të dhënat.</p> <p>c. Prezantim dhe demonstrim i rezultateve të arritura. Metoda: Puno në grupe dyshe Kontrolloni njohuritë 1,2 fq. 65.</p> <p>Vlerësimi: Kjo orë do të quhet e realizuar nëse nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> – krijon një aplikacion në <i>Visual Basic</i>, e përpilon dhe e zbaton për të parë rezultatet. <p>Të vlerësohet gjithashtu dhe puna e bërë në grupe dyshe dhe bashkëpunimi midis nxënësve, duke marrë në konsideratë kontributin e secilit nxënësi.</p>

Fusha: Teknologji/TIK	Lënda: TIK	Shkalla: V	Klasa: 11
<p>Tematika III: Programimi dhe Algoritmika Tema mësimore: Funkcionet në VB</p>		<p>Situata e të nxënit: Përdor funksionet për të realizuar një dialogim midis përdoruesit dhe kompjuterit.</p>	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:</p> <ul style="list-style-type: none"> – zhvillon aftësi, qëndrime dhe njohuri për të përdorur funksione të gatshme në VB. 			
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> – njeh disa funksione të rëndësishme në <i>Visual Basic</i>; – tregon për argumentet që merr në hyrje funksioni; MsgBox() dhe InputBox() si dhe argument të të dhënave të tipi Date dhe String; – shkruan programe duke përdorur funksionet në VB. 		<p>Fjalë kyçe:</p> <p>-<i>MsgBox()</i>, <i>InputBox()</i>, <i>Time Of Day()</i>, <i>Today()</i>, <i>Now()</i>, <i>Len()</i>, <i>Left()</i>, <i>Ucase</i>.</p>	
<p>Burimet: Libri mësimor; kompjuter; projektor digjital.</p>		<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Argëtim; gjuhë programimi.</p>	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Organizimi i orës së mësimit

a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme. Metoda: Punë përgatitore

Në një aplikacion është shumë e rëndësishme që përdoruesit të fusin të dhëna dhe t'i lexojnë ato të përpunuara nga programi. Mësuesi/ja pyet nxënësit duke përdorur njohuritë e fituara gjatë përvojave jetësore, se si realizohet një dialogim i tillë mes përdoruesit dhe kompjuterit.

b. Ndërtimi i njohurive të reja. Metoda: Veprimtari e udhëhequr

Mësuesi/ja shpjegon funksionin *MsgBox()* ku përdoruesit i shfaqet një informacion, dhe funksionin *InputBox()* i cili mund të përdoret për të futur të dhënat në program.

Sintaksat e funksioneve *MsgBox()* dhe *InputBox()* janë përkatësisht:

MsgBox(mesazhi,vlera,koka) *InputBox(mesazhi,koka,vlera)*

Mësuesi/ja ka përgatitur paraprakisht dhe demonstroi shembuj të përdorimit të funksionit *MsgBox()* dhe *InputBox()*.

Disa funksione të tjera të rëndësishme janë funksionet për të afishuar datën, orën ose orën e datën. Për t'i testuar këto funksione shkruan njëkohësisht me nxënësit shembullin në fq. 69 dhe demonstroi kodin e programit i cili lexon nga përdoruesi një tekst (**String**).

c. Prezantim dhe demonstrim i rezultateve të arritura. Metoda: Puno në grupe dyshe

Kontrolloni njohuritë 1,2 , 3 fq. 70.

Vlerësimi: Kjo orë do të quhet e realizuar nëse nxënësi:

- tregon për argumentet që merr në hyrje funksioni *MsgBox()* dhe *InputBox()* si dhe argument të të dhënave të tipit **Date** dhe **String**;
- shkruan programe të thjeshta duke përdorur funksionet në VB.

Të vlerësohet gjithashtu dhe puna e bërë në grupe dyshe dhe bashkëpunimi midis nxënësve, duke marrë në konsideratë kontributin e secilit nxënësi.

Detyrë shtëpie: Shkruani një program që shfaq datën, orën dhe sportin që dëshironi të ndiqni.

Fusha: Teknologji/TIK	Lënda: TIK	Shkalla: V	Klasa: 11
Tematika III: Programimi dhe Algoritmika <i>Tema mësimore: Funksionet në VB</i>		Situata e të nxënit: Ndërton një funksion që dëshiron në VB.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:			
– zhvillon aftësi, qëndrime dhe njohuri për të ndërtuar vetë funksione në VB.			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi:		Fjalë kyçe:	
– shkruan sintaksën për krijimin e një funksioni;		-funksione, <i>Me</i> .	
– është në gjendje të ndërtojë funksione.			

Burimet: Libri mësimor; kompjuter; projektor digjital.	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Argëtim; gjuhë programimi.
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve	
<p style="text-align: center;">Organizimi i orës së mësimit</p> <p>a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme. Metoda: Thuaj dhe trego Mësuesi/ja pyet nxënësit duke përdorur njohuritë e fituara gjatë përvojave jetësore se, përse përdoren funksionet.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Cilat janë funksionet ju njihni në <i>Visual Basic</i>? - Shkruani sintaksën e funksioneve <i>MsgBox()</i> dhe <i>Input Box()</i> dhe tregoni se çfarë argumentesh marrin në hyrje. - Tregoni për argumentet e tipit <i>Date</i> dhe <i>Sting</i>. - A mund të ndërtoni funksionet që dëshironi përveç atyre funksioneve që janë të gatshme dhe të futura në libraritë standarde të VB? <p>b. Ndërtimi i njohurive të reja. Metoda: Bazuar në kërkim Mësuesi/ja pasi ka marrë mendimet e nxënësve sqaron se sintaksa për krijimin e një funksioni është si më poshtë:</p> <p style="text-align: center;">Atributi <i>Sub</i> Emri_Funksionit(lloji i argumentit 1, lloji i argumentit 2..) <i>End_Sub</i></p> <p>Shpjegimin për ndërtimin e funksioneve si në fq. 71 do ta bëjë duke ndërtuar një aplikacion njëkohësish me nxënësit/et. Për çdo hap ose paqartësi mësuesi/ja jep sqarimet përkatëse. Elementi i ri <i>GroupBox</i> që është futur, shërben për të grupuar së bashku elementet e tjera. Do përdoren 3 <i>Checkbox-e</i> dhe 3 <i>RadioButton-e</i>, 2 <i>Button</i> dhe 2 <i>TextBox</i>. Këto funksione krijohen automatikisht përveç sintaksës së rëndë. Çdo gjë që shkruhet brenda tij do të zbatohet nëse përdoruesi klikon në Button 1 apo Button 2. Por si lexohen zgjedhjet që bën përdoruesi nga programi? P.sh., shkruajmë <i>Me.CheckBox 1</i> për të përdorur <i>CheckBox 1</i>.</p> <p>Në fund realizohet përpilimi, zbatimi i projektit dhe testimi i saj.</p> <p>c. Prezantim dhe demonstrim i rezultateve të arritura. Metoda: Bazuar në detyrë Kontrolloni njohuritë 1,2 fq. 73.</p> <p>Ushtrimi 3, nxënësit punojnë në grupe dyshe dhe mësuesi/ja jep ndihmesën e tij kur nxënësit hasin vështirësi.</p> <p>Tregoni çfarë ndodh nëse përdoruesi do të zgjedh dy ngjyra? Po nëse i zgjedh të tria?</p> <p>Vlerësimi: Kjo orë do të quhet e realizuar nëse nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> – është në gjendje të ndërtojë funksione dhe përdor fjalën kyçe <i>Me</i>, për të lexuar zgjedhjet që bën përdoruesi nga programi. <p>Të vlerësohet gjithashtu dhe puna e bërë në grupe dyshe dhe bashkëpunimi midis nxënësve, duke marrë në konsideratë kontributin e secilit nxënësi.</p>	

Fusha: Teknologji/TIK	Lënda: TIK	Shkalla: V	Klasa: 11
Tematika III: Programimi dhe Algoritmika Tema mësimore: Integrimi i bazave të të dhënave në VB		Situata e të nxënit: Lidhja e aplikacionit në VB me bazën e të dhënave <i>MS Access</i> , duke përdorur kontrollin e të dhënave ADO.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: – zhvillon aftësi, qëndrime dhe njohuri për lidhjen e aplikacionit në VB me bazën e të dhënave.			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi: – identifikon <i>ADO</i> , si një ndërfaqe programimi për hyrjen në bazën e të dhënave; – mundëson integrimin e bazave të të dhënave nga programe në VB.		Fjalë kyçe: -ADO (<i>ActiveX data Object</i>).	
Burimet: Libri mësimor; kompjuter; projektor digjital.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Argëtim; gjuhë programimi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
<p style="text-align: center;">Organizimi i orës së mësimi</p> <p>a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme. Metoda: Punë përgatitore Mësuesi/ja u kërkon nxënësve të ndërtojnë një bazë të dhënash me skedar që quhet shkolla.accdb, ndërsa tabela të quhet “nxënësi” dhe të përmbajë fushat: <i>Kodi, Emri, Mesatarja e lëndëve, Ditëlindja</i>. (mësuesi/ja duhet ta ketë ndërtuar paraprakisht). Si mund të përfshijmë këtë bazë të dhënash brenda aplikacionit në <i>Visual Basic</i>?</p> <p>b. Ndërtimi i njohurive të reja. Metoda: Veprimtari e udhëhequr Mësuesi/ja thekson se VB mund të përdoret lehtësisht për hyrjen e bazave të të dhënave dhe modifikimin e tyre, duke përdorur kontrollin e të dhënave <i>ADO</i>. Për të lidhur aplikacioni në VB me bazën e të dhënave, mësuesi/ja i demonstroi (njëkohësisht nxënësit punojnë në grupe dyshe) hapat përkatës dhe jep sqarimet e nevojshme.</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. View ->Other Windows -> Data Sources; 2. në dritaren Data Sources klikojmë tek <i>Add New Data Sources...</i>; 3. zgjedhim opsionin Database dhe klikojmë Next; 4. përzgjedhim DataSet dhe klikojmë Next; 5. te butoni browse.. vendosim skedarin shkolla.accdb dhe klikojmë OK; 6. te dritarja që hapet zgjedhim opsionin Tables; 7. te dritarja Data Sources, shohim tabelën tonë e cila është e përfshirë brenda në VB. <p>c. Prezantim dhe demonstrim i rezultateve të arritura. Metoda: Puno në dyshe <i>Kontrolloni njohuritë 1,2 , 3 fq. 76.</i></p>			
Vlerësimi: Kjo orë do të quhet e realizuar nëse nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> – tregon se ADO përdoret si një mënyrë e thjeshtë dhe e lehtë për të lidhur një aplikacion të VB me një bazë të dhënash në <i>MS Access</i>; – lidh aplikacionin në VB me bazën e të dhënave. Të vlerësohet gjithashtu dhe puna e bërë në grupe dyshe dhe bashkëpunimi midis nxënësve, duke marrë në konsideratë kontributin e secilit nxënës.			

Fusha: Teknologji/TIK	Lënda: TIK	Shkalla: V	Klasa: 11
Tematika III: Programimi dhe Algoritmika Tema mësimore: Përdorimi i bazave të të dhënave nga një aplikacion në VB		Situata e të nxënit: Leximi dhe modifikimi i bazave të të dhënave të përfshira në VB.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: – zhvillon aftësi, qëndrime dhe njohuri për përdorimin e bazës së të dhënave nga vetë aplikacion në VB.			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi: – mundëson integrimin e bazave të të dhënave nga programe në VB; – mëson përdorimin e bazës së të dhënave nga një aplikacion në VB.		Fjalë kyçe:	
Burimet: Libri mësimor; kompjuter; projektor digjital.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Argëtim; gjuhë programimi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
<p style="text-align: center;">Organizimi i orës së mësimin</p> <p>a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme. Metoda: Punë përgatitore Në aplikacionin në VB keni mësuar të përfshini një bazë të dhënash. Cilat janë hapat që një bazë e të dhënave të përfshihet brenda aplikacionit në VB? (Nxënësit mund të përdorin skedarin <i>Ushqime.accdb</i> dhe tabela “produktet” që u krijua një orë më parë.) Por si mund ta përdorim atë në një aplikacion konkret?</p> <p>b. Ndërtimi i njohurive të reja. Metoda: Veprimtari e udhëhequr Demonstron në projektor (nxënësit punojnë në kompjuter njëkohësisht) për të parë përmbajtjen bazave të të dhënave ndjek këta hapa: 1. klikojmë te Data Source dhe në dritaren që hapet zgjedhim tabelën “produktet”; 2. klikojmë secilat nga fushat dhe i tërheqim me maus për t’i vendosur te dritarja e punës. Për t’i rregulluar nga ana estetike përzgjedhim secilën nga elementet duke mbajtur shtypur tastin CTRL, klikojmë te menyja Format > Align > Lefts > Vertical Spacing > Make Equal. Përpilojmë dhe zbatojmë projektin për të përdorur aplikacionin. Duke përdorur menyën ADO, lexon të dhënat dhe i modifikon. U kërkon nxënësve të shtojnë rekorde të reja duke klikuar te +, shkruan të dhënat që dëshiron dhe klikon në Save.</p> <p>c. Prezantim dhe demonstrim i rezultateve të arritura. Metoda: Puno në dyshe <i>Kontrolloni njohuritë 1,2 fq. 78</i> Përdorni bazën e të dhënave shkolla.accdb që është përfshirë brenda aplikacionit në VB për të lexuar dhe modifikuar të dhënat. (skedari shkolla.accdb është një krijuar një orë më parë)</p>			
Vlerësimi: Kjo orë do të quhet e realizuar nëse nxënësi/ja: – lexon dhe modifikon bazën e të të dhënave të përfshira në VB. Të vlerësohet gjithashtu dhe puna e bërë në grupe dyshe dhe bashkëpunimi midis nxënësve, duke marrë në konsideratë kontributin e secilit nxënës.			

Test tremujori i dytë (Janar-Mars)

Lënda: Teknologjia e informacionit dhe komunikimit 11

Klasa XI _____

Emri Mbiemri: _____

Grupi A

Plotëso:

1. _____ realizon ndërveprimin me faqet *web*, duke trajtuar ngjarjet që ndodhin. (1 pikë)

Rretho përgjigjen e saktë. (3 pikë)

2. Sintaksa në PHP është:

- a. <?php
 echo"Pershendetje!";
?php>
- b. echo"Pershendetje!";

3. Çdo skedar që përmban kode në gjuhën PHP ruhet në kompjuter në formatin:

- a. php b. html c. js

4. Metoda *Post* përdoret për dërgimin e informacioneve të ndjeshme në server.

- a. e vërtetë b. e gabuar

5. Listo parimet e programimit në *Jquery*: (3 pikë)

- a. _____
b. _____
c. _____

6. Çfarë nënkupton me vlefshmërinë e të dhënave? (2 pikë)

7. Pse themi që gjuha PHP është gjuhë jo tipike? (2 pikë)

8. Nëse ju jepet URL-ja <http://html.net/page.php?id=1234&contact=456879>, tregoni se si mund ta interpretoni atë. (3 pikë)

9. Gjeni sa do të jetë vlera e ndryshoreve: (2 pikë)

a. Numër $1 = 7 * 3 \bmod 5 + 2 ^ 3$

b. Përgjigje = Not $4 < 5$

10. Trego pjesët përbërëse të dritares *Visual Basic*. (6 pikë)



a. title bar b. _____ c. _____ d. _____

e. _____ f. _____ g. _____

11. Shpjego sintaksën e funksionit *MsgBox* në *Visual Basic*: (3 pikë)
MsgBox (mesazhi, vlera, koka)

12. Shkruani një program në *Visual Basic*, duke përdorur funksionet e datave që shfaq në ekran datën dhe orën në dritaren dialoguese. (6 pikë)

13. Në figurën tregohet një dritare dialoguese që hapet dhe pyet përdoruesin për emrin. Pasi përdoruesi shkruan emrin, atëherë programi duhet të hapë një dritare tjetër, në të cilën afishohet “Pershendetje Emri Përdoruesit!”. Shkruani kodin për këtë program.



(5 pikë)

Nota	4	5	6	7	8	9	10
Pikët	0 – 8	9 – 13	14 – 18	19 – 23	24 – 28	29 – 32	33 – 36

Suksese!

Zhvillimi i orës së testimit për periudhës 3-mujore Janar-Mars.

Koha e zhvillimit të testit 45 min.

Sqaroj nxënësit për pyetjet e testit dhe për paqartësitë që mund të ketë.

Testi përmban 14 pyetje.

Pyetjet janë hartuar duke e bazuar në kompetencat kyçe që nxënësi duhet të zotërojë për tematikën: *Programimi në Web & Programimi dhe Algoritmika* sipas tri niveleve të taksonomisë së Blumit.

Tematika	Niveli I Njohja, Të kuptuarit	Niveli II Zbatimi Analiza	Niveli III Sinteza Vlerësimi	Pikët
III. Programimi në Web	Pyetja 1/1 pikë			1 pikë
	Pyetja 2/1 pikë			1 pikë
	Pyetja 3/1 pikë			1 pikë
	Pyetja 4/1 pikë			1 pikë
		Pyetja 5/3 pikë		3 pikë
		Pyetja 6/2 pikë		2 pikë
		Pyetja 7/2 pikë		2 pikë
		Pyetja 8/3 pikë		3 pikë
IV. Programimi dhe Algoritmika	Pyetja 9/2 pikë			2 pikë
	Pyetja 10/6 pikë			6 pikë
	Pyetja 11/3 pikë			3 pikë
			Pyetja 12/6 pikë	6 pikë
		P y e t j a 13a/4pikë	Pyetja 13b/1 pikë	5 pikë
Totali	15 pikë	14 pikë	7 pikë	14 pyetje
Pikët në përqindje sipas niveleve	15 pikë = 40% e testit	14 pikë = 40% e testit	7 pikë = 20% e testit	36 pikë

Fusha: Teknologji/TIK	Lënda: TIK	Shkalla: V	Klasa: 11
Tematika V: Gjuha e programimit JAVA <i>Tema mësimore: Krijimi i klasave</i>		Situata e të nxënësve: krijon një program të thjeshtë në <i>Java</i> , duke zbatuar konceptet e programimit nga klasa (class).	
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe: – zhvillon aftësi, qëndrime dhe njohuri për krijimin e një programi në <i>Java</i> .			
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi: – familjarizohet me teknologjinë e <i>Java</i> -s; – krijon një program në <i>Java</i> ; – njeh komandat për përpilimin dhe për ekzekutimin e programeve në <i>Java</i> .		Fjalë kyçe: –Java; JDK (Java Development Kit); Ecliper (Kepler).	
Burimet: Libri mësimor; kompjuter; projektor digjital.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Argëtim; gjuhë programimi.	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve


Organizimi i orës së mësimi

a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme. Metoda: Punë përgatitore

Për realizimin e kësaj teme mësuesi pyet nxënësit nëse e kanë njohuri për programin *Java* dhe aplikacionet e tij. Nëpërmjet diskutimit, nxënësit thonë përvojat e tyre në lidhje me këtë program që “Shkruhet një herë dhe zbatohet kudo”.

Shkruan në tabelë emrin e programit *Java* dhe më pas vizaton skemën në tabelë. (Mësuesi/ja mund ta parapërgatitë edhe në një fletë formati A4, të cilën nxënësit do ta plotësojnë në grupe dyshe).

Plotësimi i kësaj skeme do të bëhet me konceptet kryesore që nxënësit do të marrin gjatë këtij mësimi si dhe duke përdorur njohuritë e fituara nga përvojat jetësore.



b. Ndërtimi i njohurive të reja. Metoda: Veprimtari e udhëhequr

Duhet të kemi instaluar në kompjuter *JDK*-në dhe një *IDE*. Nëpërmjet diskutimit përmendin mënyrën si krijohet një kod në *Note Pad* dhe ruhet me prapashtesën *.java*. dhe të gjitha komandat që duhet të zbatohen për krijimin e programit.

<p>Ndjek mënyrën e krijimit të një programi në Java që do të bëjnë nxënësit. Kujtojnë se ku duhet krijuar kodi, përse duhet të shkruajnë të kutia dialogut <i>Run</i>, komandën <i>cmd</i>.</p> <p>Demonstrohet njëkohësisht me nxënësit, rruga për ndërtuar një projekt në <i>Eclipse (Kepler)</i>.</p> <p>c. Prezantim dhe demonstrim i rezultateve të arritura. Metoda: Puno në dyshe</p> <p>Kontrolloni njohuritë 1, 2 fq. 82.</p> <p>Shpjegoni termat më të rëndësishëm që lidhen me kodin <i>Java</i>:</p> <pre> public class ProgramiIm { public static void main(String[] args){ System.out.println(" Ju po mesoni gjuhen Java); } } </pre>
<p>Vlerësimi: Kjo orë do të quhet e realizuar nëse nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> – diskuton mbi përparësitë kryesore që e bëjnë <i>Java</i>-n një gjuhë programimi të suksesshme; – ndërtton një projekt në <i>Java</i>, duke përdorur <i>Eclipse (Kepler)</i> shkruan një kod të thjeshtë, e përpilon dhe e ruan atë. <p>Të vlerësohet gjithashtu dhe puna e bërë në grupe dyshe dhe bashkëpunimi midis nxënësve, duke marrë në konsideratë kontributin e secilit nxënësi.</p> <p>Detyrë shtëpie: Ndërtoni një projekt në <i>Java</i>, duke përdorur <i>Eclipse(Kepler)</i> për të afishuar në ekran adresën e shtëpisë suaj.</p>

Fusha: Teknologji/TIK	Lënda: TIK	Shkalla: V	Klasa: 11
Tematika V: Gjuha e programimit JAVA		Situata e të nxënit: Llojet e variablave; rregullat shkrimit të variablave; kryerja e veprimeve dhe prioriteti i veprimeve.	
<i>Tema mësimore: Vetitë e klasave në Java</i>			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:			
– zhvillon aftësi, qëndrime dhe njohuri për variablat në <i>Java</i> .			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:		Fjalë kyçe:	
Nxënësi:		-Variabla.	
– njeh variablat në <i>Java</i> ;			
– evidenton rregullat e shkrimit të variablave;			
– kryen veprime midis variablave me lloje të dhënash të njëjta ose të përafërta.			
Burimet:		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:	
Libri mësimor; kompjuter; projektor digjital.		Argëtim; gjuhë programimi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			

Organizimi i orës së mësimit**a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme Metoda: Punë përgatitore**

Për të realizuar këtë orë mësimi mësuesi/ja fton nxënësit të lexojnë aktivitetet në fq. 83. Nëse do të paraqiteshin në një program kompjuterik, këto veti do të përbënin variabla për objektin student ose rreth. Përmendni veti të tjera që lidhen me këto objekte.

b. Ndërtimi i njohurive të reja. Metoda: Veprimtari e udhëhequr

Mësuesi thekson se që një variabël të jetë i përdorshëm në një program *Java* ajo duhet të deklarohet dhe të inicializohet p.sh.:

sintaksa e deklarimit: *int* mosha;

sintaksa i inicializimit: mosha=16;

deklarim dhe inicializim së bashku: *int* mosha=16.

Shpjegon rregullat e shkrimit të variablave dhe thekson se pse është e rëndësishme që variablat të deklarohen përpara se të përdoren. Demonstron në projektor (mësuesi/ja e ka përgatitur paraprakisht) ruajtja e vlerës së një variabli dhe ndryshimi i tij. Realizohen shembuj konkret për të kuptuar veprimet midis variablave dhe duke theksuar prioritet më të larta të disa veprimeve dhe prioritet në të ulët disa të tjerë.

c. Prezantim dhe demonstrim i rezultateve të arritura. Metoda: Puno në dyshe

Kontrolloni njohuritë 1-3 fq. 85.

Vlerësimi: Kjo orë do të quhet e realizuar nëse nxënësi:

- njeh variablat, emërton variablat sipas rregullit të caktuar dhe kryen veprime me to.

Të vlerësohet gjithashtu dhe puna e bërë në grupe dyshe dhe bashkëpunimi midis nxënësve, duke marrë në konsideratë kontributin e secilit nxënësi.

Fusha: Teknologji/TIK	Lënda: TIK	Shkalla: V	Klasa: 11
Tematika V: Gjuha e programimit JAVA		Situata e të nxënit: Problemat që zgjidhen në bazë të kushteve <i>if; if...else; switch...case; for;while; do...while</i>	
Tema mësimore: Zgjidhja e problemave nëpërmjet programeve në Java			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:			
– zhvillon aftësi, qëndrime dhe njohuri për zgjidhjen e problemave nëpërmjet programeve në <i>Java</i> .			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:		Fjalë kyçe:	
Nxënësi:		- rrjedhja e kontrollit; faktoriali.	
– shkruan sintaksën e <i>if; if...else; switch...case; for;while; do...while;</i>			
– shkruan programe për zgjidhjen e problemave.			
Burimet:		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:	
Libri mësimor; kompjuter; projektor digjital.		<i>Argëtim;</i> gjuhë programimi; matematikë.	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve	
Organizimi i orës së mësimit	
<p>a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme. Metoda: Punë përgatitore</p> <p>Mësuesi/ja pyet nxënësit se cilat janë programet që zgjidhin problemet e jetës së përditshme. Pyet nëse e përdorin makinën llogaritëse në <i>smartphone</i>. Përmendni shembuj programesh në <i>Java</i> që përdoren në <i>smartphone</i>, shkencë apo në <i>Web</i> që na zgjidhin probleme nga fusha të ndryshme të jetës.</p>	
<p>b. Ndërtimi i njohurive të reja. Metoda: Veprimtari e udhëhequr</p> <p>Mësuesi/ja u kërkon nxënësve të lexojnë Problemën 1, ndërkohë që shënon në dërrasë të zezë sintaksën e kushtit të kontrollit <i>if..else</i> dhe e sqaron atë. Demonstron në projektor programi i cili konverton numrin e orëve në sekonda, ndërsa nxënësit punojnë në grupe dyshe në kompjuterat e tyre. Mësuesi/ja thekson se nëse programi duhet të testojë shumë alternativa para se të gjejë zgjidhjen e problemit duhet të përdorim sintaksën e rrjedhjes së kontrollit me <i>Switch</i>. Nxënësi shkruan në kompjuter programin i cili lexon nga përdoruesi notën e tij dhe kthen një mesazh vlerësimi.</p> <p>Në shumë raste, mënyra më e mirë për të zgjidhur një problem është duke përsëritur një ose disa veprime, një numër të caktuar herësh. Shpjegohet sintaksa e rrjedhjes së kontrollit <i>For, while dhe do...while</i>. Nxënësit punojnë në kompjuterat e tyre problemën 3 dhe 4. Mësuesi ndjek krijimin e programeve nga nxënësit.</p>	
<p>c. Prezantim dhe demonstrim i rezultateve të arritura Metoda: Puno në dyshe</p> <p>Kontrolloni njohuritë 1.2 fq. 88.</p>	
<p>Vlerësimi: Kjo orë do të quhet e realizuar nëse nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> – shkruan sintaksa e rrjedhjes së kontrollit dhe i shpjegon; – shkruan programe për zgjidhjen e detyrave. <p>Të vlerësohet gjithashtu dhe puna e bërë në grupe dyshe dhe bashkëpunimi midis nxënësve, duke marrë në konsideratë kontributin e secilit nxënësi.</p>	

Fusha: Teknologji/TIK	Lënda: TIK	Shkalla: V	Klasa: 11
<p>Tematika V: Gjuha e programimit JAVA</p> <p><i>Tema mësimore: Klasat në Java</i></p>		<p>Situata e të nxënit: krijimi i objekteve dhe klasave në <i>Java</i>.</p>	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:</p> <ul style="list-style-type: none"> – zhvillon aftësi, qëndrime dhe njohuri për krijimin klasave në <i>Java</i>. 			
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> – deklaron metodën; – krijon klasat në <i>Java</i>. 		<p>Fjalë kyçe:</p> <p>-klasa; void.</p>	

Burimet: Libri mësimor; kompjuter; projektor digjital.	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Argëtim; gjuhë programimi; matematikë.
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve	
<p style="text-align: center;">Organizimi i orës së mësimi</p> <p>a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme. Metoda: Punë përgatitore Mësuesi u kërkon nxënësve të ndërtojnë shembullin 1 të dhënë në librin e nxënësve. Ndjek nga afër realizimin e detyrës. Mësuesi u kërkon nxënësve të thonë duke u bazuar në njohuritë e marra ose nga përvojat jetësore se çfarë janë “metodat” dhe “klasat” në Java.</p> <p>b. Ndërtimi i njohurive të reja. Metoda: Veprimtari e udhëhequr Mësuesi thekson se metodat janë funksione në <i>Java</i> dhe tregojnë përbërësit kryesorë të tij. Ndërsa klasat në <i>Java</i> paraqesin një bashkësi variablash dhe metodash, që shërbejnë për kryerjen e disa veprimeve të caktuara brenda një programi kompjuterik. Demonstron në projektor (nxënësit punojnë në kompjuterat e tyre) krijimin e klasës Kafshe_Shtëpiake duke dhënë sqarimet e nevojshme për karakteristikat dhe veprimet që objektet do të kryejnë. Vihet re se brenda klasës Kafshe_Shtëpiake nuk ka një metodë <i>main</i>, për të bërë të mundur zbatimin e kësaj klase ndërtojmë një klasë të dytë. Pasi deklarojmë metodat realizojmë afishimin në <i>Consol</i> pas thirrjes së metodave të klasës Kafshe_Shtëpiake.</p> <p>c. Prezantim dhe demonstrim i rezultateve të arritura. Metoda: Puno në dyshe Kontrolloni njohuritë 1.2. fq. 91.</p>	
<p>Vlerësimi: Kjo orë do të quhet e realizuar nëse nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> – krijon një klasë, shkruan metodat brenda klasës, ku dallon prototipin dhe trupin e metodës dhe më pas teston metodën. <p>Të vlerësohet gjithashtu dhe puna e bërë në grupe dyshe dhe bashkëpunimi midis nxënësve, duke marrë në konsideratë kontributin e secilit nxënësi.</p> <p>Detyrë shtëpie: 3 fq. 91</p>	

Fusha: Teknologji/TIK	Lënda: TIK	Shkalla: V	Klasa: 11
Tematika V: Gjuha e programimit JAVA Tema mësimore: Objektet në Java. Konstruktorët dhe destrukturët		Situata e të nxënit: krijimi i objekteve nëpërmjet konstruktorëve në <i>Java</i> .	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: <ul style="list-style-type: none"> – zhvillon aftësi, qëndrime dhe njohuri për krijimin objekteve në <i>Java</i>. 			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> – di të krijojë objekte në <i>Java</i>; – di të thërrasë metodat e klasave në <i>Java</i>; – njeh konceptin e variablave publik dhe privat; – njeh konstruktorët dhe destrukturët në <i>Java</i>. 		Fjalë kyçe: -objekte, konstruktorët, destrukturët, klasat <i>public/private</i> .	

<p>Burimet: Libri mësues; kompjuter; projektor digjital.</p>	<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Argëtim; gjuhë programimi; matematikë.</p>
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</p>	
<p style="text-align: center;">Organizimi i orës së mësimit</p> <p>a. Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme. Metoda: Punë përgatitore Mësuesi u kërkon nxënësve të lexojnë shembullin 1 të dhënë në librin e nxënësve.</p> <p>b. Ndërtimi i njohurive të reja. Metoda: Veprimtari e udhëhequr Mësuesi thekson se qëllimi i përdorimit të trashëgimisë dhe sintaksën e përcaktuar për një operacion trashëgimie:</p> <pre>public class Emri_Klasa_Fëmijë extends Emri_Klasa_prind { trupi i klasës}</pre> <p>Demonstron krijimin e një klase të re <i>PeshkuKuq</i> e cila ka si “prind” klasën <i>Kafshë_Shtëpiake</i>. Mësuesi shpjegon karakteristikat e konstruktorit dhe demonstron në projektor shembullin në fq. 95.</p> <p>Sqarohet se kur përdoret fjala kyçe <i>public</i> dhe <i>private</i>. N</p> <p>c. Prezantim dhe demonstrim i rezultateve të arritura. Metoda: Puno në dyshe Kontrolloni njohuritë 1, 2, 3 fq. 93 dhe 1.2 fq. 95.</p>	
<p>Vlerësimi: Kjo orë do të quhet e realizuar nëse nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> – krijon objekte në Java; – njeh konceptin e variablave publik dhe privat; – dallon konstruktorët dhe destruktoret në Java. <p>Të vlerësohet gjithashtu dhe puna e bërë në grupe dyshe dhe bashkëpunimi midis nxënësve, duke marrë në konsideratë kontributin e secilit nxënës.</p>	

Test tremujori i tretë (Prill-Qeshor)**Lënda: Teknologjia e informacionit dhe komunikimit 11**

Klasa XI _____

Emri Mbiemri: _____

Grupi A**Plotëso:**

1. _____ është një gjuhë e orientuar në objekte. (1 pikë)

Rretho përgjigjen e saktë. (2 pikë)2. *Visual Basic* mund të përdoret lehtësisht për hyrjen në bazat e të dhënave dhe modifikimin e tyre.

a. e vërtetë b. e gabuar

3. ADO (*ActiveX Data Object*) përdoret për të lidhur një aplikacion në *Visual basic* me bazën e të dhënave në *MS Access*.

a. e vërtetë b. e gabuar

4. Listo tiparet e *Java*-s: (3 pikë)

a. është gjuhë e thjeshtë për t'u mësuar, shkruar dhe kuptuar.

b. _____

c. _____

d. _____

5. Përcaktoni se cilët nga emrat e mëposhtëm mund të jetë një emër për variablat: (2 pikë)

a. Adresa b. 9Ditë c. #ndryshues d. KohaDje

6. Shpjegoni sintaksën për krijimin e një funksioni në *Visual Basic*: (3 pikë)Atributi *Sub* Emri_Funksionit (lloji i argumentit 1, lloji i argumentit 2...)*End sub*

a. artibuti-

b. Emri i funksionit -

c. Lloji -

7 - a. Shpjego sintaksën e ciklit *While*: (2 pikë)*While*(kushti për qëndrimin në cikël)

{trupi i ciklit;}

{vetëm që ekzekutohen vetëm kur përfundon cikli;}

8. Tregoni termat më të rëndësishëm që lidhen me kodin *Java*: (4 pikë)

```
public class ProgramiIm {
    public static void main(String[] args) {
        System.out.println(" Ju po mesoni gjuhen Java);
    }
}
```

9. Shkruani një program, i cili konverton numrin e ditët në sekonda. Nëse përdoruesi fut një numër negativ, program duhet të afishojë një mesazh gabimi. (6 pikë)

10. a- Deklaroni një klasë të quajtur Nxënësi, ku karakteristikat janë: emri, mbiemri dhe viti i lindjes. (7 pikë)

b- Në klasën Nxënësi, shtoni metodën Gjej moshën (intvitiaktual), e cila llogarit moshën e nxënësit duke njohur vitin e tij të lindjes. (3 pikë)

Nota	4	5	6	7	8	9	10
Pikët	0 – 7	8 – 12	13 – 17	18 – 21	22 – 25	26 – 29	30 – 33

Suksese!

Zhvillimi i orës së testimit për periudhës 3-mujore Prill-Qershor.

Koha e zhvillimit të testit 45 min.

Sqaroj nxënësit për pyetjet e testit dhe për paqartësitë që mund të ketë.

Testi përmban 10 pyetje.

Pyetjet janë hartuar duke e bazuar në kompetencat kyçe që nxënësi duhet të zotërojë për tematikën: *Programimi dhe Algoritmika & Gjuha e programimit Java* sipas tri niveleve të taksonomisë së Blumit.

Tematika	Niveli I Njohja, Të kuptuarit	Niveli II Zbatimi Analiza	Niveli III Sinteza Vlerësimi	Pikët
IV. Programimi dhe Algoritmika	Pyetja 2/1 pikë			1 pikë
	Pyetja 3/1 pikë			1 pikë
		Pyetja 6/3 pikë		3 pikë
V. Gjuha e programimit Java	Pyetja 1/1 pikë			1 pikë
	Pyetja 4/3 pikë			3 pikë
	Pyetja 5/2 pikë			2 pikë
		Pyetja 7/2 pikë		2 pikë
		Pyetja 8/4 pikë		4 pikë
	Pyetja 9a/5 pikë	Pyetja 9a/1 pikë		6 pikë
		Pyetja 10b/3 pikë	Pyetja 10a/7 pikë	10 pikë
Totali	13 pikë	13 pikë	7 pikë	12 pyetje
Pikët në përqindje sipas niveleve	13 pikë = 40% e testit	13 pikë = 40% e testit	7 pikë = 20% e testit	33 pikë

Vlerësimi i punës së bërë gjatë këtij projekti bazohet në:

- shkallën e realizimit të objektivave të vëna;
- nivelin shkencor të arritur;
- mënyrën e paraqitjes së projektit;
- efikasitetin e ndarjes së detyrave brenda grupit.

Teknika e vlerësimit të nxënësve:**- Metoda organizative (Vlerësime në grup)**

“Të gjithë anëtarët e grupit do të vlerësohen për prezantimin përfundimtar të grupit. Kjo do të zërë rreth 80% të vlerësimit. Gjithashtu unë do t’ju vlerësoj individualisht për gatishmërinë që do të tregoni për të bashkëpunuar brenda grupit. Kjo do të zërë 20%. Pastaj të dyja këto vlerësime do të mblidhen së bashku për të dhënë notën prej 100%”

Nivelet	Kriteret
Pakalues (Nota 4)	Nuk paraqitet raporti dhe nuk dorëzohet produkti. Ose: Raporti ka gabime të shumta për sa u përket njohurive. Mungojnë argumentet. Nuk ka bashkëpunim në grup. Nuk janë respektuar afatet.
Bazë (Notat 5 dhe 6)	Pak burime informacioni. Kopjime nga informacionet. Pak argumente. Nxënësit përpiqen të bashkëpunojnë. Përgjithësisht janë zbatuar afatet. Raporti me gabime gjuhësore dhe i pastrukturuar. Prezantimi i përciptë.
Mesatar (Notat 7 dhe 8)	Disa burime informacioni. Përpunim i mirë i informacioneve. Argumente të mira. Të përpiktë në afatet. Nxënësit bashkëpunojnë. Parashtrimi me shkrim me pak gabime gjuhësore dhe i strukturuar mirë.
I lartë (Notat 9 dhe 10)	Larmi burimesh të informacionit. Gjykime kritike ndaj informacioneve. Ide origjinale. Të gjithë nxënësit punojnë në mënyrë të pavarur dhe në grup. Parashtrimi me shkrim korrekt dhe i strukturuar mirë.

Formular vlerësimi

Emri _____ Mbiemri _____

Grupi _____

Tema për të cilën u punua: _____

I. Jepni mendimin tuaj për frytshmërinë e punës me projekte në grup:

1. A do të punoje në të njëjtin grup përsëri? _____ Pse? _____

2. Çfarë ju pëlqeu më shumë nga puna në grup? _____

3. Për të realizuar një projekt tjetër, do të zgjidhni punë në grup apo punë individuale? _____

4. A të ofron puna me projekte një të mësuar efektiv? _____ Pse? _____

5. A gjejnë hapësirën e duhur interesat e tua te puna me projekte? _____ Pse ? _____

II. Bëni vlerësimin e punës së shokëve tuaj të grupit:

1. Si e vlerësoni nivelin e përgatitjes shkencore të projektit tuaj? _____

2. Si ka funksionuar fryma e bashkëpunimit në grup? _____

3. A ndeshët vështirësi në organizimin e punës ? _____ Nëse po, si u zgjidhën ato? _____

4. Si e vlerësoni mënyrën e paraqitjes së materialit të grupit tuaj? _____

5. Çfarë mendoni se duhet përmirësuar? _____

III. Bëni vlerësimin e punës së shokëve tuaj të grupeve të tjera:

1. Si e vlerësoni nivelin e përgatitjes shkencore të projektit të përgatitur nga shokët e grupeve të tjera? _____

2. Si e vlerësoni mënyrën e paraqitjes së materialit të përgatitur nga shokët e grupeve të tjera? _____

3. Çfarë mendoni se duhet përmirësuar? _____

Ju faleminderit!

Vlerësimi i projektit**Emri i nxënësit:****Përshkrimi i temës/projektit:**

Nr.	A. VEÇORITË ORGANIZATIVE	Po	Jo	Komente
1.	Nxënësi i kuptoi objektivat e detyrës.			
2.	Nxënësi i kuptoi kërkesat specifike të detyrës.			
3.	Nxënësi e kuptoi afatin kohor të detyrës.			
4.	Nxënësi i kuptoi metodën, procedurën, kriteret me të cilat do të vlerësohet detyra.			
5.	Nxënësi kishte mundësi të diskutonte detyrën.			
6.	Detyra është brenda mundësive të nxënësit.			
7.	Gjatë fazave të zhvillimit të detyrës janë zhvilluar konsultime me nxënësit.			
	B. NXËNIA E NXËNËSIT	Po	Jo	Komente
1	Nxënësi formuloi vetë pyetjet dhe gjeti përgjigje për to.			
2	Nxënësi tregoi fakte të iniciativës individuale.			
3	Nxënësi shkëmbeu ide me të tjerët për zhvillimin e detyrës.			
4	Nxënësi solli referenca të nxënies para kësaj eksperience ose nga fusha të tjera që lidhen me këtë përvojë.			
5	Nxënësi punoi në mënyrë metodologjike për të realizuar këtë detyrë.			
6	Evidencat në detyrë ekzistojnë në formën e mëposhtme: <ul style="list-style-type: none"> • Planifikim • Organizim • Interpretim • Nxjertje përfundimi • Analizë • Aplikim • Sintezë • Hipotezë • Parashikim • Vlerësim 			
7	Aspekte teknike të detyrës reflektojnë saktësi dhe përshtatshmëri. <ul style="list-style-type: none"> • Struktura e fjalisë • Pikësimi • Shqiptimi • Shkrimi • Informacioni i përfshirë në detyrë 			

Vlerësimi i punës së nxënësve në një projekt kryhet nga disa pikëvështrime:

<p>A. Plani i projektit</p> <ul style="list-style-type: none"> - Sa qartë e kanë përshkruar nxënësit objektivin (objektivat) e projektit? - A kanë hartuar një plan të mirë? 			
<p>B. Zbatimi i planit</p> <ul style="list-style-type: none"> - Sa i respektojnë afatet? - A është përmirësuar plani gjatë zbatimit? 			
<p>C. Menaxhimi i informacionit</p> <ul style="list-style-type: none"> - Sa shterues është kërkimi në tekstet shkollore? - Sa të larmishme janë burimet e informacionit? - A kanë mbajtur shënime nga informacionit? - A mbahet qëndrim kritik ndaj informacioneve? 			
<p>D. Etika e punës në grup</p> <ul style="list-style-type: none"> - A punojnë që të gjithë nxënësit? - Mos mbizotëron një pakicë në kryerjen e punëve? - Po në diskutimet? - A arrijnë nxënësit në kompromise? - A sillen ata me takt ndaj njëri-tjetrit? - A sjellin argument gjatë diskutimeve? - A janë bindëse argumentet? 			
<p>E. Raporti përfundimtar</p> <ul style="list-style-type: none"> - A ka ide origjinale? - A është strukturuar qartë raporti? - Si bëhet vetëvlerësimi? 			
<p>F. Prezantimi</p> <ul style="list-style-type: none"> - A është i qartë prezantimi? - A është tërheqës? - A përfshihen në prezantim disa nxënës? 			
<p>G. Të tjera</p> <ul style="list-style-type: none"> - A ka raporti pjesë të kopjuara? <i>(Kopjimi ul notën menjëherë.)</i> - A është e saktë gjuha e shkruar? - A është shkruar me stil tërheqës? 			

VLERËSIMI I AFTËSISË SË NXËNËSIT NË PËRDORIMIN E INFORMACIONIT

Emri i nxënësit: _____

1. Nxënësi është i aftë të formulojë qëllimin e mbledhjes së informacionit:

2. Nxënësi është i aftë të mbledh informacionin nga bagazhi i tij i nxënies në të shkuarën:

3. Nxënësi është i aftë të identifikojë elementet kryesore që duhen në informacion:

4. Nxënësi është i aftë të organizojë informacionin në njësi të përdorshme:

5. Nxënësi është i aftë të identifikojë detajet që kanë lidhje me njëra-tjetrën:

Portofoli i projektit

- ❖ Plani i projektit.
 - ❖ Planet vetjake të nxënësve.
 - ❖ Shënimet gjatë takimeve të grupit.
 - ❖ Një listë e burimeve të informacionit.
 - ❖ Të tjera që nxënësit dëshirojnë t'i evidentojnë, si: fotografi, episode interesante gjatë punës etj.
- Titulli i projektit.
 - Objektivat e projektit.
 - Një listë me njohuritë kryesore lëndore të cilat do të përvetësohen ose do të merren në sajë të projektit.
 - Partnerët nëse ka (prindër, OJF etj.).
 - Numri i nxënësve që përfshihen në projekt ose numri i klasave.
 - Përshkrimi përmbledhës i veprimtarive kryesore përkatëse, i ndarë në hapat kryesorë.
 - Burimet kryesore të informacionit.
 - Përshkrimi i produktit të informacionit.
 - Tematika e secilës orë mësimore në kuadrin e projektit.
 - Mënyra e vlerësimit të nxënësve.

Përdorimi i teknologjisë në mënyrë të përshtatshme dhe efektshme për të mbështetur mësimdhënien, për të shtuar mundësitë e të mësuarit dhe për të rritur shanset për suksesin e të mësuarit.

Përdorimi i kompjuterëve dhe teknologjisë së bazuar te kompjuterat në mësimdhënien e përgjithshme, ka shumë përparësi dhe mund të lehtësojë zmadhohë procesin e mësimdhënies/të mësuarit në shumë mënyra. Si mësues, ju mund të përdorni lloje të ndryshme të programeve kompjuterike edukative, që variojnë nga programet ushtrim –e-praktikë deri te programet për punë praktike, simulime dhe lojërat instruktive deri te *spreadsheets dhe bazave të të dhënave*. Ju mund të përdorni programet e përpunimit të fjalës për t'i nxitur nxënësit të shkruajnë referate më kompetente sepse programi e bën më të lehtë të fusësh tekstin, ta rishikosh dhe ta redaktosh atë aq shpesh sa nevojitet. Tabelat e bardha interaktive (SMART Boards) që përdorin zbulimin me prekje për të dhënat e përdoruesit, kontribuojnë në joshjen e mësimdhënies. Programi i zbatuar në këto tabela interaktive, i lejon mësuesit që t'i mbajnë konspektet e shënimit si skedarë elektronikë dhe t'ua shpërndajë ato nxënësve, në letër me anë të postës elektronike ose në *uebsajtet* ose në platformat e tyre të të mësuarit elektronik. Madje disa modele i lejojnë mësuesit ta regjistrojnë mësimdhënien e tyre si skedar shifror video, të cilët mund të jenë shumë të dobishëm për nxënësit që mungojnë nga shkolla, apo për ata që përfitojnë nga përsëritja dhe u duhet ta shikojnë përsëri materialin.

Interneti është një instrument i rëndësishëm i të mësuarit dhe në shumicën e rasteve siguron një informacion më bashkëkohor apo më të përditësuar sesa tekstet mësimore. Interneti siguron aksesin në bazë shumë të madhe të të dhënave për një grup të stërmadh temash. Informacioni jepet nga qeveritë dhe organizatat joqeveritare, kolegjet, universitetet, arkivat, bibliotekat dhe muzetë, kompanitë dhe individët. Gjithashtu internet siguron shumë shërbime dhe mund të jetë dobiprurës për mësuesit dhe nxënësit, midis tyre sistemet e nxjerrjes së informacionit hipermedial, që lidhin një larmi materialesh të internetit (duke përfshirë grafika, radio, tekst të thjeshtë, hiperlinke) dhe shërbimesh komunikimi që i lejojnë mësuesit dhe nxënësit të komunikojnë me njëri-tjetrin me anë të mesazheve me tekst, të zërit apo videos (p.sh., e-mail, Skype). Më në fund, interneti mund të përdoret në klasa për të edukuar të mësuarit bashkëpunues. Nxënësit janë në gjendje të shkëmbejnë zbulimet dhe të mbështesin njëri-tjetrin. Një bashkëpunim i tillë jo vetëm jep si rezultat përfitime akademike por po ashtu edhe shoqërore.

Së fundmi, internet mund të përdoret për të shtuar njohuritë e një mësuesi dhe të kuptuarit çfarë dhe si të jap mësim. Janë në kuptim të plotë të fjalës mijëra uebsajte të ndërtuar, për t'i pajisur mësuesit me njohuri të përmbajtjes, material, udhëzime, dhe këshillë. Faqet e rrjeteve sociale, blogjet, wikis, faqet për shkëmbimin e videove dhe platformave të tjera vetë botuese, etiketat dhe kujtesat, lejojnë që të bëni më shumë sesa të nxirrni informacion. Ato u japin mundësi të ndërveproni, bashkëpunoni e shkëmbejeni informacion dhe ide, suksese dhe mossuksese.

Ashtu si të gjithë burimet e të mësuarit vetëm përdorimi i teknologjisë nuk garanton që do të ndodhë të mësuarit e dëshiruar. Çështja nuk është se sa mësues e nxënës përdorin teknologjinë, por sa me efektshmëri e përdorim atë në mënyrë që të përmirësojnë cilësinë e procesit të mësimdhënies/të mësuarit. Ashtu si edhe për burimet e tjera të të mësuarit, teknologjitë e përshtatshme dhe të vlefshme do të varen nga objektivat e të mësuarit dhe nga nxënësit të cilëve u jepet mësim. Pa një lidhje me objektivat e të mësuarit, teknologjia mund të jetë kundërproduktive dhe realisht të të largojë nga të mësuarit.

VLERËSIMI I INFORMACIONIT TË PËRFITUAR NGA FAQET E INTERNETIT

<p style="writing-mode: vertical-rl; transform: rotate(180deg);">QËLLIMI DHE AUTORITETI</p>	<ul style="list-style-type: none"> • A është qëllimi i faqes në <i>web</i> i pohuar qartë në faqen fillestare apo në faqet pasuese? • A mund të përcaktohet autori i faqes? A jep autori ndonjë informacion për formimin e tij/saj, kualifikimet dhe/ose ekspertizën. A është dhënë informacioni i kontaktit (emri, <i>email</i>, numri i telefonit ose një adresë). • A është autori i lidhur me një organizatë apo flet nga ana e vet? • A është faqja në <i>web</i> e sponsorizuar nga ndonjë grup i veçantë, institucion, kompani apo organ qeveritar? A e pakëson apo e rrit kjo besueshmërinë e saj? • Në qoftë se nuk ka informacion rreth autorit dhe/ose sponsorit të faqes në <i>web</i>, a ka ndonjë mënyrë tjetër për të përcaktuar origjinën e saj? Shihni për shembull për një titull a poshtëshënim që tregon përkatësinë, shihni adresën në <i>web</i> ose URL, ose në fushën. Emri i fushës mund të ndihmojë të përcaktohet origjina e faqes <i>web</i>. Për shembull ac.(academic), edu. (institucion arsimor), com. (organizatë tregtare), org. (organizatë jofitimprurës), net. (portë internet ose administrator, organizata të përfshira në teknologjinë e rrjeteve ose madje edhe emri për qëllim të përgjithshëm, emri i hapësirës), gov. (departamenti i qeverisë).
<p style="writing-mode: vertical-rl; transform: rotate(180deg);">SAKTËSIA E OBJEKTIVITETIT</p>	<ul style="list-style-type: none"> • A është dhënë burimi i informacionit? • A ka ndonjë tregues të paragjyqimeve? A është ndërtuar faqja për të ndikuar opinionet? • Kush është audiencia e synuar? • Cili është thelbi i informacionit? • A është informacion i besueshëm dhe pa gabime? • A ka ndonjë reklamë në faqe?
<p style="writing-mode: vertical-rl; transform: rotate(180deg);">AKTUALITETI</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Është faqja e datuar? Janë përfshirë datat (p.sh., data e “postuar së pari” data “përditësuar së fundmi”)? • Nëse është kështu kur ishte përditësimi i fundit? A është informacioni bashkëkohor apo i vjetruar? • Sa bashkëkohor janë <i>link</i>-et? A kanë skaduar apo janë disa?
<p style="writing-mode: vertical-rl; transform: rotate(180deg);">PËRMBAJTJA</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Cilat temat pasqyrohen? A korrespondojnë ato me programin mësimor? • A ofron kjo faqe diçka që nxënësit nuk mund ta gjejnë gjetkë? • Cila është thellësia e pasqyrimin të informacionit? • A është ajo e përshtatshme për moshën, njohuritë e mëparshme dhe përvojën e nxënësve tuaj?
<p style="writing-mode: vertical-rl; transform: rotate(180deg);">NDËRTIMI</p>	<ul style="list-style-type: none"> • A duket profesional prezantimi? • A është faqja e lehtë për ta përdorur dhe e mirëorganizuar? • A lidhen në mënyrë adekuate <i>link</i>-et nga faqja? • A është i nevojshëm një softuer apo harduer i veçantë për të parë tërë faqen (p.sh., për pjesën me zë apo video)?

Pavarësisht nga burimet e të mësuarit që ju përzgjidhni apo krijoni, është përgjegjësia juaj që t’i bëni ato të “vijjnë në jetë” te nxënësit tuaj. Mbani mend që burimet e të mësuarit, madje edhe më interaktivet si interneti, janë vetëm instrumente, jeni ju ata që duhet t’i përdorni ato mirë dhe me mençuri.

Vlerësimi oi portofolit të lëndës së TIK-ut:

Në lëndën e TIK-ut, mësuesi në bashkëpunim me nxënësit, ka përcaktuar 3 detyra dhe 1 projekt për portofolin e periudhës së parë, i cili do të ketë gjithsej 40 pikë. Për vlerësimin e portofolit, mësuesi **përcakton vetë** pikët/peshat për secilën detyrë.

- a. Tri sulmet më të bujshme që kanë ndodhur vitet e fundit. (10 pikë)
- b. Ndërtimi i një tabele në *MS Access* me njohuritë e marra. (10 pikë)
- c. Ndërtimi i formularit në *MS Access*. (10 pikë)
- d. Projekti – (punë grupi). (10 pikë)

P.sh. Vlerësimi me pikë

Detyra	Detyra 1	Detyra 2	Detyra 3	Projekti	Portofoli
Nota	10 pikë	10 pikë	10 pikë	10 pikë	40 pikë

Sipas tabelës së vlerësimit me notë , vlerësimi i këtij portofoli është si më poshtë .

Nota	4	5	6	7	8	9	10
Pikët	> 10	11 – 15	16 – 20	21 – 25	26 – 30	31 – 35	36 – 40